Programi Edukativ

Atletika për Fëmijë

PËRKTHYER DHE PËRGATITUR NGA **GJERGJ RULI** DHE **NIKOLIN DIONISI**

Programi Edukativ

Atletika për Fëmijë

Edicioni 2006
Punuar dhe prodhuar nga Grupi i Punës i përbërë nga:
Charles Gozzoli (FRA)
Jamel Simohamed (ALG)
Abdel Malek El-Hebil (MAR)

Udhëzime praktike : Trajnimi për eventet e Atletikës për Fëmijë

Programi Edukativ për fëmijët e moshës 7-12 vjeç (Atletika për Fëmijë)

Për çdo event të Atletikës për Fëmijë, 5 module edukative rekomandohet të prezantohen me 5 situata të ndryshme trajnimi.

Ky program nuk ndjek një progresion të mirëfilltë mësimdhënie. Ai thjesht prezanton 5 situata të ndryshme trajnimi për pjesëmarrësit e vegjël. Është përgjegjësia e organizatorit që të përzgjedhë dhe të organizojë seancat duke marrë parasysh nevojat e fëmijëve.

Disa evente nuk zhvillohen përpikmërisht sipas 5 programeve edukative, për tre arsyet e mëposhtme:

- Në evente të hapura, organizatorët duhet të tregojnë aftësi minimale për të pasur ide të reja në kuadër të trajnimit:

(Sh.: Për të përgatitur shënjestrën e eventit të hedhjeve, çdo objekt hedhjeje mund të konsiderohet si një ushtrim trajnues (topa të sporteve të ndryshme, lojëra aftësie, etj.)

- Në disa evente të cilat përafrohen me eventet e parashikuara për të rriturit, ne nuk duam ti shtyjmë fëmijët, brënda kornizës së Atletikës për Fëmije, në asnjë trajnim specifik të këtyre eventeve. Situata të ndryshme trajnimi për përgatitjen e një eventi janë të mjaftueshme për tu siguruar që ata të ballafaqohen me evente të reja në të ardhmen.

(Sh.: Gara e vrapimit të 1000m përgatitet nga 8 min. Rezistencë dhe Rezistencë Progresive).

- Nëse një event është i një forme progresive nga një event tjetër, si nuk ofron situata të tjera trajnimi përveç atyre përgatitëse të këtij eventi.

(Sh.: Kërcimi 3-Hapësh brënda një zone të limituar përgatitet nga vrapime të shkurtra të 3-Hapësh)

KUJDES

Disa module edukative nuk korrespondojnë me Eventet e Atletikës për Fëmijë të IAAF-it (Ecje Sportive, Kërcim së Larti) për arsyet e mëposhtme:

- *Siguria e pjesëmarrësve (Kërcimi së Larti: rënie pa dyshek)*
- *Kompleksiteti teknik (Ecje Sportive, kërcim fosburi)*

Gjithsesi, rekomandohet të prezantohen këto praktika kërcimi/ecje nëpërmjet ushtrimesh përgatitëse, pasi këto evente do ti paraqiten fëmijëve në një fazë të mëvonshme.

Gjergj RULI, Nikolin DIONISI

MODULE EDUKATIVE : SPRINT/PENGESA SHKËPUTJE STAFETË

Analiza e eventit: Eventi kërkon përvetësimin e kalimit të pengesave të ulëta me shpejtësinë e vrapimit dhe aftësinë e organizimit të hapave të duhura përgjatë një distance të caktuar.

Siguria e pjesëmarrësve: Përzgjedhja e zonës për praktikim është e rëndësishme (e butë, jo e rrëshqitshme, e sheshtë). Zgjedhja e pengesave është gjithashtu një pikë kyçe për sigurinë (të sigurta: të lehta, të plota, etj.).

Figurë



Event nga Kompeticion i IAAF – Atletika për Fëmijë

Moduli Edukativ 1: SPRINT/PENGESA SHKËPUTJE STAFETË

Objektivi: **Përmirësimi i kalimit të pengesave**

Situata e propozuar: Organizoni një kurs me mjete të ndryshme për praktikimin e kërcimit (kalim vertikal - horizontal) të vendosura në mënyrë të rastësishme.

Sjellja e fillestarëve: Fillestarët janë hezitues përpara pengesave, dhe shpesh bien në pozicionin e sigurisë (mbi dy këmbë).

Udhëzime për ushtrimin:
- Vraponi sa më rregullisht të jetë e mundur
- Bëni një kalim të shpejtë në vrapim pas pengesave

Pika të dallueshme:
- Mbani ekuilibër pas pengesave
- Përvetësoni kalimin e pengesave me një pozicion afërsisht horizontal
- Mos ngadalësoni përpara pengesave
- Përdorni segmentet e lira për të nxituar dhe jo për ekuilibrim

Progresion mësimdhënës:
- Ndryshoni pengesat (të larta, të ulëta, të gjata, të shumëllojshme)
- Ndryshoni distancat ndërmjet pengesave
- Ndryshoni sekuencat e ushtrimeve
- Orientohuni drejt lojrave individuale ose kolektive

Siguria:
- Kurse të sigurta
- Pengesa të përshtatshme

Bazë materiale:
- Shënjues horizontalë
- Shënjues vertikalë për kursin

Moduli Edukativ 2: SPRINT/PENGESA SHKËPUTJE STAFETË

Objektivi: **Për të përmirësuar organizimin ndërmjet vijës së nisjes dhe pengesës së parë.**
Situata e propozuar: 3 korsi të ndryshme vrapimi (5m, 6m, 7m) në dispozicion të pjesëmarrësve si në vijim:

Filloni nga një traversë e vogël mbi tokë
Pengesa të sigurta janë të vendosura në një gjatësi prej 5m, 6m, 7m (duhet të jenë të ulëta për tu kaluar lehtësisht).





Pozicioni fillestar

Udhëzime për ushtrimin:
- Mos ngadalësoni përpara pengesave
- Nxitoni, rrisni shpejtësinë deri në vijën e finishit
- Bëni një kalim të shpejtë në vrapim pas pengesave

Pika të dallueshme:
- Rritje progresive e vrapimit drejt pengesave
- Amplitudë progresive e hapit të shpejtë
- Kërcimi bëhet larg nga pengesa
- Rënie aktive dhe në ekuilibër pas kalimit të pengesave

Progresion mësimdhënës:
- Ndryshoni distancat
- Vraponi në çifte
- Mbani kohën
- Orientohuni drejt lojrave

Siguria:
- Korsi të sigurta
- Lartësi e përshtatshme pengesash dhe hapësirë ndërmjet korsive të vrapimit.
- Organizime në grupe

Bazë materiale:
- Pengesa
- Shënjues vertikalë në korsi

Moduli Edukativ 3: SPRINT/PENGESA SHKËPUTJE STAFETË

Objektivi: **Përmirësimi i hapave të vrapimit përgjatë distancave dhe ndërmjet pengesave**

Situata e propozuar: Mundësoni që distancat ndërmjetëse të vijnë gradualisht në rritje dhe kërkojini pjesëmarrësve të ushtrohen me amplitudën e hapit vrapues dhe numrin e hapave(të detyrueshme ose jo).

Sjellja e fillestarëve: Fillestarët do të ushtrohen me numrin e hapave duke mbajtur ritmin e tyre të rregullt; ata bien në pozicionin e sigurisë (mbi dy këmbë).



Udhëzime për ushtrimin:
- Punoni mbi amplituda të ndryshme hapash
- Mbani shpejtësinë e vrapimit

Pika të dallueshme:
- Mbani ritëm të rregullt
- Strategjia e ruajtjes së vrapimit
- Ekuilibri dhe pozicionimi i përgjithshëm korrekt mirëmbahen

Progresion mësimdhënës:
- Ndryshoni distancat
- Ndryshoni kërkesat
- Mbani kohën
- Orientohuni drejt lojrave individuale ose kolektive

Siguria:
- Vend jo i rrëshqitshëm
- Pengesa të sigurta
- Organizim në grupe

Bazë materiale:
- Pengesa
- Shënjues vertikalë

Moduli Edukativ 4: SPRINT/PENGESA SHKËPUTJE STAFETË

Objektivi: **Për të përmirësuar mbajtjen e stafetës**

Situata e propozuar: Marrje dhe lënia e një stafete (që mund të jetë top tenisi, unazë plastike, stafetë, etj.) e vendosur në lartësinë e mesit me shpejtësinë e vrapimit.

Sjellja e fillestarëve: Fillestarët kanë vështirësi të mëdha në ndarjen e krahut të veprimit nga vrapimi. Krahu i tyre shoqëron lëvizjen e sprintit dhe nuk mund të kryejë një veprim të saktë.



Udhëzime për ushtrimin:
- Qëndroni në pozicion relaksimi
- Mos e ktheni kokën në drejtim të shënjestrës

Pika të dallueshme:
- Marrja/Lënia e mjeteve me preçizion dhe rregullsi
- Jo ndërprerje në momentin e sprintit (vetëm nga krahu mbajtës i stafetës)
- Evitim i humbjes së shpejtësisë përgjatë ushtrimit

Progresion mësimdhënës:
- Ndryshoni mjetet dhe shpejtësinë
- Përdorni krahun e majtë dhe të djathtë
- Kompletoni sekuencat : lënie/marrje, marrje/lënie
- Përmirësoni ushtrimin duke ndryshuar krahët
- Orientohuni drejt lojrave

Siguria:
- Kurs pa pengesa
- Organizim në grupe
- Stafeta të vendoset në lartësinë e duhur

Bazë materiale:
- Stafeta dhe mjete të ndryshme
- Mbështetje për stafetat

Moduli Edukativ 5: SPRINT/PENGESA SHKËPUTJE STAFETË

Objektivi: **Për të përmirësuar ndërrimin dhe reagimin ndaj një sinjali fillestar zanor ose vizual.**

Situata e propozuar: Pas dhënies së një sinjali dy pjesëmarrës startojnë njëkohësisht, në 10m distancë dhe përballe nga njëri tjetri. Ata do bëjnë kalimin në shpejtësi e sipër dhe do kompletojnë ushtrimin duke ngadalësuar.

Sjellja e fillestarëve: Fillestarët do të kenë vështirësi të vendosin me cilën dorë do e marrin stafetën. Ata shpesh vendosen përballë vrapuesit tjetër. Ata mbeten shumë të ngathët gjatë ndërrimit të stafetës.



Udhëzime për ushtrimin:
- Vraponi në trajektore të ndryshme, në anën e stafetës
- Veprim i saktë i lëvizjes së krahut për marrjen e stafetës

Pika të dallueshme:
- Mos e lëshoni stafetën
- Të dy pjesëmarrësit nuk duhet të ngadalësojnë
- Ndërrimet janë të suksesshme mbi një bazë të rregullt

Progresion mësimdhënës:
- Ndryshoni duart në të dyja anët
- Rrisni shpejtësinë
- Ndryshoni formën e stafetës
- Mbani kohën (linjat e startit/finishit janë të njëjta)
- Orientohuni drejt lojrave

Siguria:
- Organizim në grupe
- Stafeta të sigurta
- Trajektore të shënuara qartësisht

Bazë materiale:
- Shënjues vertikalë
- Stafeta

MODUL EDUKATIV : 8 MIN. REZISTENCË

Analiza e eventit: Ky event kërkon bindjen me shpejtësinë e vrapimit duke ju përmbajtur kërkesave strikte të vrapimit. Ky është një event individual me sfond ekipor. Secili pjesëmarrës mban një shpejtësi konstante në ndihmesë të ekipit të tyre.

Udhëzime për sigurinë e pjesëmarrësve: Parapërgatitja për eventin është padyshim garancia më e mirë e sigurisë. Shënuesit përgjatë distancës, por gjithashtu edhe pika e referimit për ekipet duhet të jenë të sigurta. Mësuesit në çdo bazë do duhet ti japin këshilla secilit prej fëmijëve pas mbarimit të çdo xhiroje.

Situata e eventit : Atletika për Fëmijë





Në këtë event fëmijët do përpiqen të mbajnë një shpejtësi të rregullt. Kjo do të garantojë përvetësimin sa më të mirë të ushtrimit.

Moduli Edukativ 1: Gara e 8 min. Rezistencë

Objektivi: **Kontrollimi i shpejtësisë së vrapimit**

Situata e propozuar: Përgjatë një distance 100-200m, vraponi me shpejtësi të ndryshme duke ju përmbajtur udhëzimeve të dhëna nga instruktori. Mbajtja e një shpejtësie të rregullt do të jetë kërkesa e parë.

Sjellja e fillestarëve: Fillestarët do të kenë vështirësi të mëdha në ndjekjen e udhëzimeve dhe në vrapimin me një shpejtësi të rregullt.



Udhëzime për ushtrimin:
- Ndryshoni shpejtësinë e vrapit gradualisht
- Rregulloni frymëmarrjen dhe merrni frymë lirisht

Pika të dallueshme:
- Respektim i udhëzimeve të dhëna
- Frymëmarrje e lehtë

Progresion mësimdhënie:
- Vraponi me ritme të ndryshme në çdo zonë
- Vraponi në distanca të ndryshme
- Vraponi në gara kolektive (vrapim në çifte përkrah njëri-tjetrit, vrapim në çifte pas njëri tjetrit, et.)
- Orientohuni drejt lojrave

Siguria:
- Kurs i sigurtë
- Shpejtësi e përshtatshme për nivelin e aftësisë
- Kohëzgjatje e përshtatshme për ushtrimin

Bazë materiale:
- mjete të shënuara
- bilbil ose sinjal tjetër starti

Moduli Edukativ 2 : Gara e 8 min. Rezistencë

Objektivi: **Rregullimi i frymëmarrjes së secilit përgjatë ushtrimit fizik**

Situata e propozuar: Në një kurs të arritshëm, pjesëmarrësit eksperimentojnë lloje të ndryshme ciklesh frymëmarrjeje të mundshme me një shpejtësi mesatare.

Sjellja e fillestarëve: Fillestarët do të kontrollojnë frymëmarrjen e tyre mekanikisht dhe do të kenë vështirësi të mbajnë ritmin, veçanërisht kur do të lëshojnë frymën.



Udhëzime për ushtrimin:
- Filloni me cikle fillestare frymëmarrjeje
- Lëshoni zë në momentin e nxjerrjes së frymës

Pika të dallueshme:
- Aftësi në ndjekjen e udhëzimeve
- Asnjë shenjë të problemeve fiziologjike

Progresion mësimdhënie:
- Rregullimi i llojeve të ndryshme ciklesh frymëmarrje
- Vrapim me ndihma ritmike
- Vrapim në distanca të variueshme duke ndryshuar shpejtësinë
- Orientohuni drejt lojrave

Siguria:
- Kurs i sigurtë
- Shpejtësi e përshtatshme për nivelin e aftësisë
- Kohëzgjatje e përshtatshme për ushtrimin

Bazë materiale:
- Mjete të shënjuara
- bilbil ose sinjal tjetër starti

Moduli Edukativ 3 : Gara e 8 min. Rezistencë

Objektivi: **Gjetja e ritmit për secilin**

Situata e propozuar: Zbulimi i një programi të shkurtër sekuencial vrapimi më një shpejtësi vrapimi individuale.
Garat do të zhvillohen kryesisht përgjatë distancave 100-400m dhe do të përsëriten 2 deri në 4 herë në mënyrë që të perfeksionohet rregulli i vrapimit. (Kjo është shumë më e rëndësishme sesa rritja e rezistencës fizike)

Sjellja e fillestarëve: Fillestarët hasin vështirësi në respektimin e sekuencave të vrapimit në nivele specifike të shpejtësisë.

Udhëzime për ushtrimin:
- Respektoni distancat dhe nivelet e shpejtësisë të caktuara
- Merrni frymë lirisht dhe qëndroni të relaksuar

Pika të dallueshme:
- Përvetësim i niveleve të propozuara të shpejtësisë
- Lehtësi relative fiziologjike
- Mbikqyrje e shenjave të tendosjeve (lodhjeve) fizike

Progresion mësimdhënie:
- Çdo konfigurim është i mundshëm në vartësi të nivelit të aftësisë së fëmijëve. Objektivi kryesor është qe ata të provojnë forma të ndryshme përpjekjesh fizike.

Siguria:
- Përpjekje të përshtatshme
- Rimëkëmbje e saktë
- Kontroll i rrahjeve të zemrës
- Mbikqyrje e shenjave të lodhjeve fizike

Bazë materiale:
- Shënjues
- Kronometër
- Shirit matës

Moduli Edukativ 4 : Gara e 8 min. Rezistencë

Objektivi: **Mësimi i vrapimit në grup**

Situata e propozuar: Grupe të ndryshme fëmijësh në gara të ndryshme (distanca dhe shpejtësi të ndryshme) të lidhur nga një litar (ose mjet tjetër: breza mesi, tuba biçiklete) ose të detyruar të vrapojnë në grupe të ndryshme.

Sjellja e fillestarëve: Përballe problemeve të garës kolektive, fillestarët do të përgjigjen me një ndryshim shumë të dallueshëm drejtimi ose shpejtësie. Ata e rregullojnë ritmin e tyre gjatë progresionit të garës në një moment sa më të vonshëm të mundshëm.



Udhëzime për ushtrimin:
- Reagoni në rregullimin e garës sa më shpejtë të jetë e mundur
- Përshtatuni me një amplitudë të reduktuar hapi
- Mbani shikimin tek vrapuesi udhëheqës

Pika të dallueshme:
- Arritja e përshtatjes së kërkuar gradualisht
- Rregullim i hapit dhe frekuencës së ritmit lehtësisht

Progresion mësimdhënie:
- Ndryshoni kurset
- Impononi të vrapojnë në një shpejtësi më të madhe
- Zgjeroni grupin
- Mbani kohën
- Orientohuni drejt lojrave

Siguria:
- Zonë vrapimit e sigurtë
- Organizim në grupe (sipas udhëzimeve)
- Përmbajuni objektivave të çdo ushtrimi

Bazë materiale:
- Shënjues vertikalë
- Lidhje ekipore (tub gome, etj.)

Moduli Edukativ 5 : Gara e 8 min. Rezistencë

Objektivi: **Rregullimi hapi i njërit me hapin e tjetrit**

Situata e propozuar: Në korsi të ndryshme, vrapuesit duhet të rregullojnë hapin e tyre me hapin e udhëheqësit të grupit, ose afër atij/asaj, ose edhe larg tij/saj.

Sjellja e fillestarëve: Fillestarët kanë vështirësi të mëdha të përcaktojnë shpejtësinë e vrapuesve të tjerë dhe të përshtaten me ta. Sa më larg të jenë ata, sa më të ndryshme të jenë korsitë aq më shumë probleme do kenë ata. Ata do të përshtaten ose do të përpiqen të përshtaten në hapat finalë të tyre.



Udhëzime për ushtrimin:
- Merrni sa më shume pika referimi të jetë e mundur tek vrapuesit në sfond
- Vraponi sa më shpejtë të jetë e mundur

Pika të dallueshme:
- Arritje e synimeve të kërkuara
- Rregullim i lehtë me vrapin e udhëheqësit
- Hap i lehte vrapimi

Progresion mësimdhënie:
- Ndryshoni kurset
- Ndryshoni plozionet udhëheqës/ndjekës
- Orientohuni drejt lojrave

Siguria:
- Kurs dhe zonë e sigurtë
- Organizim në grupe (sipas udhëzimeve)

Bazë materiale:
- Shënjues vertikalë

MODUL EDUKATIV: GARA E FORMULA UNO

Analiza e eventit: Gara e Formula Uno-s është një aktivitet shumëplanësh në të cilin kombinohen rrotullimi përpara, sprinti, sllallomi dhe kalimi i pengesave. Secili element mund t'i nënshtrohet ndryshimeve në terren.

Udhëzime për sigurinë e pjesëmarrësve: Pajisje dhe terren i sigurtë me një distancë maksimale 60-70 cm.

Figure



Event nga Kompeticion i IAAF – Atletika për Fëmijë

Modul Edukativ 1: Formula 1

Objektivi: **Eksperiment i përgjithshëm i rrokullisjes nga përpara**

Situata e propozuar: Bëni një rrotullim të plotë përpara në një sipërfaqe me pjerrësi; Ky pozicion i lehtëson gjërat dhe u mundëson fëmijëve përvetësimin e sekuencës së startit/rrotullimit. Në një terren të butës ose në dyshekë, kryeni rrotullime përpara duke rënë në tokë me të dyja këmbët dhe duke i mbajtur gjunjët të mbledhur.

Sjellja e fillestarëve: Fillestarët nuk e mbajnë pozicionin e mbledhur të trupit përgjatë gjithë rrotullimit; ata shpesh zgjasin gjymtyrët e tyre më të ulët të cilët e pengojnë atë nga zbritja në këmbët e tyre.





Udhëzime për ushtrimin:
- Mbani mjekrën mbi kraharor deri sa ushtrimi të përfundojë
- Mbështetuni në duart e një personi në vijën e fillimit

Kriteret për një performancë të suksesshme:
- Mbani pozicionin e mbledhur të trupit gjatë rrotullimit
- Ruani shpejtësinë në momentin e rënies në dy këmbë
- Rrokullisuni në drejtim të zhvendosjes

Progresion mësimdhënës:
- Ndryshoni sipërfaqet e pjerrësisë
- Ndryshoni rrotullimet (së prapthi, të ndara, etj.)
- Ndryshoni pozicionet e startit (në gjunjë, gjysmë në gjunjë, etj.)
- Pas rënies në tokë, përdorni suportin e krahëve
- Orientohuni drejt lojrave

Siguria:
- Sipërfaqe me pjerrësi të përshtatshme
- Organizim i rreptë, strikt
- Organizimi i grupeve

Bazë materiale:
- Sipërfaqe e pjerrët
- Dyshekë

Modul Edukativ 2: Formula 1

Objektivi: **Eksperimentim dhe përvetësim i kalimit të pengesave**

Situata e propozuar: Fëmijët vrapojnë në distanca me pengesa të ulëta dhe të papërcaktuara. Çdo korsi do jetë e ndryshme; numri i pengesave mund të variojë nga 1 në 10 hapa largësi nga njëri-tjetri.

Sjellja e fillestarëve: Fillestarët shpesh ngadalësojnë hapin përpara pengesave në mënyrë që të rregullojnë ritmin e tyre dhe pastaj i kapërcejnë. Rënia pas pengesave shpesh kryhet në pozicionin e sigurisë (rënie në tokë me dy këmbë)



Udhëzime për ushtrimin:
- Lidhni vrapimin dhe kalimin e pengesave
- Arrini të shkëputeni nga toka me të dyja këmbët përpara pengesave

Kriteret për një performancë të suksesshme:
- Mos humbisni ekuilibrin
- Mos humbisni shpejtësinë gjatë afrimit me pengesat
- Mbani pozicionin e vrapimit gjatë kalimit të pengesave (krahët, pozicioni i trupit, etj.)

Progresion mësimdhënës:
- Ndryshoni korsitë
- Kurs i drejtë pastaj i lakuar
- Ndryshoni lartësinë e pengesave (gamë më të ulët)
- Lidhni pengesat me kalimin e zonës së ujit
- Përparoni drejt lojrave (si p.sh. stafetë)

Siguria:
- Kurs i sigurtë
- Pengesa të sigurta

Bazë materiale:
- Lloje të ndryshme pengesash
- Shënjues

Modul Edukativ 3: Formula 1

Objektivi: **Eksperimentim dhe përvetësim i sllallomit të sprintit**

Situata e propozuar: Garë me shënjues të ndryshëm për sllallomin e sprintit : distanca midis shënjuesve për të provuar të gjitha kthesat e mundshme.

Sjellja e fillestarëve: Fillestarët shpesh kanë tendencën të ndryshojnë ritmin e tyre që të kompletojnë sllallomin (synojnë të ndryshojnë drejtimin e zhvendosjes, trupi nuk është më në drejtimin e garës).



Udhëzime për ushtrimin:
- Vraponi sa më rregullisht të jetë e mundur
- Mbani trupin në drejtim të garës

Pika të dallueshme:
- Respektim i udhëzimeve të dhëna
- Mbajtja e trupit në drejtimin e garës
- Mbajtja e pozicionit të vrapimit (krahët, etj.)
- Vrapim i shpejtë

Progresion mësimdhënës:
- Varioni korsitë më së shumti
- Varioni fushën (e sheshtë, e pjerrët, etj.)
- Varioni shpejtësinë
- Orientohuni drejt lojrave (si p.sh. stafetë)

Siguria:
- Kurs i sigurtë
- Organizimi i grupeve

Bazë materiale:
- Shënjues

Modul Edukativ 4: Formula 1

Objektivi: **Përmirësim i vrapimit në kthesa**

Situata e propozuar: Në momentin e sprintit, reagim ndaj udhëzimeve në situata të variueshme, arritje e distancës së vrapimit në kthesa me rreze të ndryshme.

Sjellja e fillestarëve: Fillestarët shpesh kryejnë vrapimin në kthesa duke ulur cilësinë e shpejtësisë (krahët, pozicionet e pikave). Ata shpesh vrapojnë në të njëjtën distancë lakorje për të kompletuar lloje të ndryshme kthesash.

Udhëzime për ushtrimin:
- Vraponi sa më rregullisht të jetë e mundur pavarësisht kthesave
- Vështroni në brendësi të kthesës

Pika të dallueshme:
- Kryerje e suksesshme e ushtrimeve të dhëna
- Në kthesa, pozicion i pjerrët dhe në të njëjtën linjë i trupit
- Rregullim i ngjashëm në kthesat e majta dhe të djathta

Progresion mësimdhënës:
- Varioni rrezen e kthesave më së shumti
- Rrisni shpejtësinë
- Vononi dhënien e sinjalit për kthesën e zgjedhur
- Orientohuni drejt lojrave

Siguria:
- Terren jo i rrëshqitshëm
- Organizimi i grupeve

Bazë materiale:
- Shënjues vertikalë

Modul Edukativ 5: Formula 1

Objektivi: **Përvetësimi i një starti sa më të mirë**

Situata e propozuar: Nga pozicionime të ndryshme të trupit, të gjithë duke nënkuptuar një pozicionim të ulur, pjesëmarrësit do duhet të kryejnë starte efikase.

Sjellja e fillestarëve: Fillestarët kanë tendencën të ngrihen përpara se të kalojnë në pozicionin e vrapimit.





Udhëzime për ushtrimin:
- Përdorni shtytjen maksimale të këmbës në start
- Përdorni paqëndrueshmërinë pas pozicionimit të startit për të lëvizur më shpejt

Pika të dallueshme:
- Gjymtyrët e poshtme janë të zgjatur plotësisht
- Humbje e ekuilibrit të përparmë përgjatë hapave të parë
- Përdorim i krahëve për të përmirësuar cilësinë e startit

Progresion mësimdhënës:
- Varioni pozicionet e startit më së shumti
- Mbani kohën për distancat 10m
- Paraqisni sfida për ti përfshirë
- Orientohuni drejt lojrave

Siguria:
- Terren jo i rrëshqitshëm dhe i butë
- Organizimi i grupeve

Bazë materiale:
- Shënjues vertikalë
- Kronometër

MODUL EDUKATIV : KËRCIM NGA VENDI

Analiza e eventit : Mënyrë kërcimi që vë në dukje jo vetëm fuqinë e gjymtyrëve të poshtme, por gjithashtu edhe koordinimin midis këmbëve dhe krahëve, veprimin simetrik të gjymtyrëve të poshtme, dhe më në fund pranimin e paqëndrueshmërisë së përparme nga fëmijët.

Udhëzime për sigurinë e pjesëmarrësve : Siguria e eventit duhet të garantohet nga një terren i butë dhe jo i rrëshqitshëm duke ofruar udhëzimet e kërkuara për mbrojtjen pas rënies.

Event nga Kompeticion i IAAF – Atletika për Fëmijë

Modul Edukativ 1: Kërcim nga vendi

Objektivi: **Për të eksperimentuar kërcimin më të ulët në tokë dhe për të mësuar përthithjen e fazës së uljes pas kërcimit nga vendi.**

Situata e propozuar: Nga një kuti apo ndonjë mjet tjetër të përshtatshëm me aftësitë e fëmijëve (20 cm janë mjaftueshëm si fillim), kryeni një kërcim për të rënë në tokë me të dyja këmbët.

Sjellja e fillestarëve: Fillestarët shpesh shohin këmbët e tyre ndërkohë që bien në tokë dhe shpesh kanë një pozicionim "të përthyer" të trupit, pa përvetësim me gjymtyrët më të ulëta.



Udhëzime për ushtrimin:
- Mos bëni zhurmë gjatë rënies
- Mbani bustin ne pozicion të drejtë

Kriteret për një performancë të suksesshme:
- Rënie me të dyja këmbët në të njëjtën kohë
- Përvetësim i rënies me këmbët të përthyera
- Mbajtja e trupit në pozicion vertikal

Progresion mësimdhënës:
- Realizoni kërcimet me plan, me objektiva
- Lidhni kërcimet e ulëta në tokë të variueshme deri në sekuenca
- Kërceni duke mbajtur një mjet çfarëdo (top, letër, etj.)
- Orientohuni drejt lojrave

Siguria:
- Terren i butë
- Struktura e lartë të jetë e qëndrueshme
- Lartësi e përshtatshme

Bazë materiale:
- Një strukturë e lartë
- Dyshekë në rast nevoje

Modul Edukativ 2: Kërcim nga vendi

Objektivi: **Për të eksperimentuar kërcimin me dy këmbë dhe përthyerjen e gjymtyrëve të poshtme për një rënie të mëpasshme.**

Situata e propozuar: Kërcim mbi një sipërfaqe të përshtatshme (20 cm janë të mjaftueshme si fillim) dhe arritja e një pozicionimi të qëndrueshëm rënieje (matni kërcimin dhe rrotullimin e trupit).

Sjellja e fillestarëve: Për arsye sigurie, fillestarët kanë tendencën të përshpejtojnë rënien mbi sipërfaqe duke reduktuar dallueshëm kërcimin me të dyja këmbët.



Udhëzime për ushtrimin:
- Qëndroni afër me strukturën e lartë
- Ngrini këmbën përpara se të kërceni

Pika të dallueshme:
- Rënie e ekuilibruar
- Kërcim i plotë me gjymtyrët e poshtme
- Veprim i menjëhershëm i krahëve
- Busti i trupit është pothuajse në pozicion vertikal

Progresion mësimdhënës:
- Varioni lartësinë e strukturës së sipërme (brenda kufijve të mundësive)
- Kërceni mbi objektiva
- Lidhni kërcimet me veprime të tjera: si p.sh. me një hedhje objekti ose një kërcim të ulët, etj.)
- Orientohuni drejt lojrave

Siguria:
- Struktura e lartë të jetë e sigurtë
- Lartësi e përshtatshme

Bazë materiale:
- Një strukturë e lartë

Modul Edukativ 3: Kërcim nga vendi

Objektivi: **Përvetësimi i kërcimeve të ndryshme me dy këmbë**

Situata e propozuar : Në një lojë kërcimesh për fëmijë (lojë fëmijësh me kërcime kryq për shembull), pjesëmarrësit kryejnë kërcime në të djathtë, në të majtë, me rotacion, etj.

Sjellja e fillestarëve : Fillestarët shpesh shohin këmbët e tyre për të siguruar rënien e saktë. Ata realizojnë rotacionin me shpatullat e tyre në vend të këmbëve të tyre.



Udhëzime për ushtrimin:
- Mos shikoni këmbët
- Varioni rotacionet nga e majta në të djathtë

Kriteret për një performancë të suksesshme:
- Kompletoni kërcimet e parashikuara
- Mbani ekuilibrin
- Kërceni me të dyja këmbët njëkohësisht

Progresion mësimdhënës:
- Varioni lojrat e kërcimeve
- Lidhni dy ose tre kërcime së bashku me ndalesa ndërmjetëse
- Orientohuni drejt lojrave

Siguria:
- Terren jo i rrëshqitshëm
- Sipërfaqe kërcimi e dallueshme

Bazë materiale:
- Dyshekë në rast nevoje
- Shënjues horizontalë

Modul Edukativ 4: Kërcim nga vendi

Objektivi: **Mësimi i lëvizjeve të kërcimeve me dy këmbë**

Situata e propozuar : Realizoni sa më shumë kërcime përpara me dy këmbë me largësi të ndryshme.

Sjellja e fillestarëve : Fillestarët kanë vështirësi të kryejnë kërcime të shumta; gjymtyrët e tyre të poshtme shpesh janë të përthyera shumë. Krahët kanë një efekt ekuilibrues.



Udhëzime për ushtrimin:
- Këmbët të mos jenë shumë të përthyera
- Përdorni krahët
- Mbani shikimin ku do hidheni

Pika të dallueshme:
- Sekuenca e kërcimeve
- Ekuilibër i përgjithshëm
- Efektshmëri, performancë

Progresion mësimdhënës:
- Ndryshoni natyrën e terrenit (bar, rërë, dyshekë, etj.)
- Varioni amplitudën me rrjeta dhe linja

Siguria:
- Terren i butë dhe jo i rrëshqitshëm
- Organizimi i grupeve
- Distancë e përshtatshme kërcimi (e shkurtër)

Bazë materiale:
- Shënjues horizontalë
- Dyshekë

Modul Edukativ 5: Kërcim nga vendi

Objektivi: **Përmirësimi i shtytjes së këmbëve**

Situata e propozuar : Fëmijët të kryejnë një kërcim vertikal me të dyja këmbët me synimin për të kapur një shënjestër të dhënë.

Sjellja e fillestarëve : Fillestarët nuk përdorin të gjitha mundësitë e veprimeve muskulore. Sekuenca e veprimeve është shpesh e paefektshme.





Udhëzime për ushtrimin:
- Shtytje e gjatë nga thembra deri tek gishtat e këmbëve
- Kërceni duke përdorur krahët
- Mbani shikim drejt ndërkohë që kërceni

Pika të dallueshme:
- Përfundim me këmbë plotësisht të tendosura
- Kërcim vertikal i saktë

Progresion mësimdhënës:
- Prekni objektivin me dorën e djathtë dhe të majtë
- Kryeni disa kërcime të ndryshme
- Orientohuni drejt lojrave

Siguria:
- Terren i drejtë dhe i butë
- Objektiv i siguruar

Bazë materiale:
- Shënjestra, objektiva

MODUL EDUKATIV: PËRSHKALLËZIMI I SHPEJTËSISË

Analiza e eventit : Përshkallëzimi i shpejtësisë kërkon kompetencën e saktësisë në mbështetje të rënies me shpejtësinë e vrapimit dhe aftësinë për të krijuar mbështetje të lartë frekuence.

Udhëzime për sigurinë e pjesëmarrësve : Shënjuesit në tokë që kufizojnë "përshkallëzimin" duhet të jenë të sigurtë. Terreni duhet të jetë i butë dhe jo i rrëshqitshëm. Një seance nxemjeje paraprake është e nevojshme për këtë event.

Figurë





Event nga Kompeticion i IAAF – Atletika për Fëmijë

Modul Edukativ 1: Përshkallëzimi i shpejtësisë

Objektivi : **Punoni me frekuencën e shkëputjes**

Seancë model : Punoni me një daulle (ose çfarëdo mjeti muzikor) duke ndryshuar kohën e frekuencës dhe rregullimin e shkëputjes me anë të tingullit.

Sjellja e fillestarëve : Fillestarët do të punojnë me frekuencën e tingullit të imponuar, duke iu përgjigjur në një mënyrë të tensionuar dhe të vonuar.



Udhëzime për ushtrimin:
- Ndiqni tingullin e dhënë
- Qëndroni të relaksuar

Pika të dallueshme:
- Ndiqni frekuencën e kërkuar
- Mbani një shpejtësi vrapimi
- Mundohuni të ndjeni më shumë tingullin dhe rrahjen sesa ta mendoni

Progresion mësimdhënës:
- Variacion i ritmit dhe frekuencës
- Variacion i tingullit si dhe të ndihmesave vizuale (shokë ekipi, të tjerë)
- Orientohuni drejt lojrave

Siguria:
- Frekuenca të përshtatshme
- Organizimi i grupeve

Bazë materiale:
- Zona vrapimi të shënjuara

Modul Edukativ 2: Përshkallëzimi i shpejtësisë

Objektivi : **Përmirësimi i precizionit të rënies**

Situata e propozuar : Atletët vrapojnë në distanca të ndryshme të shënjuara në tokë me variacion hapash.

Sjellja e fillestarëve : Fillestarët do të kenë vështirësi të vrapojnë ne hapësirat të cilat janë të ndryshme nga hapat e tyre. Ata shpesh do të mbajnë shikimin te këmbët e tyre dhe do të bien mbi gishtat e këmbëve.



Udhëzime për ushtrimin:
- Vraponi sa më natyrshëm
- Mos mbani shikimin tek këmbët

Pika të dallueshme:
- Respektoni distancat e dhëna
- Mbani shpejtësinë e vrapimit

Progresion mësimdhënës:
- Shfrytëzoni shpejtësi të ndryshueshme
- Kërkoni shkëputjen nga suporte specifike
- Orientohuni drejt lojrave

Siguria:
- Shënjues dhe terren i sigurtë
- Hapësira të përshtatshme
- Organizimi i grupeve

Bazë materiale:
- Shënjues horizontalë
- Shënjues vertikalë

Modul Edukativ 3: Përshkallëzimi i shpejtësisë

Objektivi : **Baza e frekuencave të larta të hapave**

Situata e propozuar : Në një bazë pak të pjerrët (2% më së shumti), menaxhoni hapësirat të cilat vijnë duke u ngushtuar me shënjues. Kërkojini pjesëmarrësve të vrapojnë me shpejtësi të lartë dhe sigurohuni që secila këmbë të jetë në zonën midis shënjuesve.

Sjellja e fillestarëve : Fillestarët zakonisht nuk i respektojnë distancat e shkurtra midis shënjuesve dhe mbajnë shpejtësinë e hapave. Hapi i tyre përkeqësohet (vrapim në majë të gishtave).



Udhëzime për ushtrimin:
- Mbani një pozicion të saktë vrapimi
- Shikoni ku po vraponi

Pika të dallueshme:
- Respektim i distancave
- Mbajtje e shpejtësisë së vrapimit

Progresion mësimdhënës:
- Varioni zonën e ushtrimeve
- Organizoni evente vrapimi me dy kundërshtarë
- Orientohuni drejt lojrave

Siguria:
- Pjerrësi e përshtatshme
- Mbani zonën e finishit të lirë
- Organizimi i grupeve

Bazë materiale:
- Shënjues horizontalë
- Shënjues vertikalë

Modul Edukativ 4: Përshkallëzimi i shpejtësisë

Objektivi : **Përmirësimi i kthimeve duke filluar nga ana e majtë dhe e djathtë**

Situata e propozuar : Në një distancë prej 8m e kufizuar me dy blloqe të larta, pjesëmarrësit duhet të vrapojnë para dhe prapa, të prekin blloqet (ose të marrin një top tenisi apo çfarëdo mbi blloqet) njëherë me dorën e majtë dhe herën tjetër me të djathtën (ose mund të kalojnë përreth bllokut).

Sjellja e fillestarëve : Fillestarët do të kenë vështirësi të ristartojnë sërish furishëm (mungesë force dhe pozicionim i ulët i trupit); ata janë shpesh të ngathët kur prekin blloqet.



Udhëzime për ushtrimin:
- Shikoni blloqet (ose konet)
- Vraponi në krah (në vartësi të dorës së prekjes) përgjatë dy hapave të fundit
- Përdorni krahët të startoni sërish

Pika të dallueshme:
- Mosprekja e koneve me dorën e gabuar (ndërthurin kahet)
- Nuk rrëzohen ndërkohë që startojnë sërish pas prekjes së koneve

Progresion mësimdhënës:
- Varioni distancat dhe lartësinë e koneve (jo shumë të ulëta)
- Organizoni vrapimet si duele
- Mundohuni të kryeni vrapime para dhe prapa duke i kaluar përreth konit nga e majta dhe nga e djathta
- Mbani kohën
- Orientohuni drejt lojrave

Siguria:
- Terren jo i rrëshqitshëm
- Blloqe ose kone jo shumë të ulëta
- Numër i limituar përsëritjesh

Bazë materiale:
- Kone, blloqe
- Kronometër
- Top tenisi ose të tjerë

Modul Edukativ 5: Përshkallëzimi i shpejtësisë (si një event stafete)

Objektivi: **Sigurimi i një kalimi efektiv**

Situata e propozuar: Pas një starti të njëkohësishëm ballor prej 10m, dy pjesëmarrës do ti kalojnë njëri tjetrit stafetën duke vrapuar dhe do të mbajnë stafetën pa ngadalësuar.

Sjellja e fillestarëve : Fillestarët nuk do të jenë të sigurtë me cilën dorë do marrin stafetën, ata kanë tendencën të qëndrojnë përballë vrapuesit me stafetë. Ata do të ngathtësohen gjatë kalimit të stafetës.



Udhëzime për ushtrimin:
- Vrapuesit duhet të jenë në anën e stafetës që e mban vrapuesi përballë
- Lëvizje precize e krahut për të marrë stafetën

Pika të dallueshme:
- Stafeta nuk bie në tokë
- Të dy pjesëmarrësit nuk ngadalësojnë
- Sukses konstant i kalimit të stafetës

Progresion mësimdhënës:
- Ndryshoni krahët për të dyja pozicionet
- Kryeni eventit duke rritur shpejtësinë
- Varioni mjetet për kalimin e stafetës
- Mbani kohën (starti dhe finishi në të njëjtin vend)
- Orientohuni drejt lojrave

Siguria:
- Organizimi i grupeve
- Stafetë e sigurtë
- Drejtimet e vrapimit të jenë të qarta

Bazë materiale:
- Shënjues vertikalë
- Stafeta

MODUL EDUKATIV: HEDHJE E KRYQËZUAR

Analiza e situatës: Ky event kërkon përvetësimin e shkëputjes nga toka me dy këmbë duke përdorur lëvizjen e kryqëzuar të muskujve. Gjithashtu ky event kërkon kontroll motorik të trupit përgjatë një ushtrimi të organizuar dhe të gjatë.

Siguria e pjesëmarrësve: Terreni duhet të jetë i shkrifët, jo i rrëshqitshëm dhe i niveluar (i drejtë). Shënjuesit në tokë duhet të jenë të dukshëm dhe të sigurtë.

Figurë



Event nga Kompeticion i IAAF – Atletika për Fëmijë

Modul Edukativ 1: Hedhje e kryqëzuar

Objektivi: **Eksperimentimi i shkëputjes nga toka me dy këmbë**

Seancë model: Lojë kërcimesh në zona të ndryshueshme, me anë të shkëputjes nga toka me dy këmbë.

Sjellja e fillestarëve: Fillestarët shpesh mbajnë shikimin të këmbët e tyre dhe ndalojnë përgjatë dy kërcimeve : kërcimet nuk janë të lidhura me njëra-tjetrën.

Udhëzime për ushtrimin:
- Kërceni me të dyja këmbët
- Shkëputuni nga toka më të dyja këmbët njëkohësisht

Pika të dallueshme:
- Mbajtje e trupit në pozicion vertikal (i drejtë dhe i qëndrueshëm)
- Kërcim me të dyja këmbët njëkohësisht
- Përdorim i krahëve gjatë shkëputjes

Progresion mësimdhënës:
- Punoni në zona akoma dhe më komplekse
- Provoni teknika të ndryshme shkëputjesh : e thjeshtë, dyfish, etj.
- Provoni rotacionin (kthimin së prapthi) dhe ekuilibrimin gjatë shkëputjes
- Zhvillim drejt aktiviteteve lojrash

Siguria:
- Terren jo i rrëshqitshëm
- Organizimi i grupeve

Bazë materiale:
- Terren i drejtë
- Zonë e shënjuar

Modul Edukativ 2: Hedhje e kryqëzuar

Objektivi: **Kontrollimi i një sekuence të gjatë motorike themelore**

Situata e propozuar: Kërcime anësore mbi pengesa të kapërcyeshme duke ndjekur një sekuencë "të përparme", me kthim sistematik në pikën e startit 0 (nga 0 tek 1 dhe kthim në 0, pastaj 1 dhe 2 dhe sërish kthim tek 0, etj.)

Sjellja e fillestarëve: Fillestarët shpesh kanë vështirësi të kërcejnë nga e djathta në të majtë. Ata kanë probleme në memorizimin e sekuencës.



Pika të dallueshme:
- Ekuilibër përgjatë ushtrimit
- Punë në kërcimin muskulor
- Lëvizje në të njëjtin plan të pengesave
- Mbajtje e trupit drejt
- Përdorim i krahëve gjatë shkëputjes nga toka

Progresion mësimdhënës:
- Duke lëvizur përpara, sportistët kërcejnë përpara, pastaj në të majtë, pastaj përpara, pastaj në të djathtë, etj. nëpërmjet një përshkallëzuesi shpejtësie
- Lëvizje sllallomi më shkëputje nga toka më dy këmbë
- Lëvizje përmes rrathësh të përcaktuar në mënyrë të rastësishme
- Zhvillim drejt aktiviteteve lojrash

Siguria:
- Terren jo i rrëshqitshëm
- Pengesa të sigurta dhe të përshtatshme
- Organizimi i grupeve

Bazë materiale:
- Pengesa
- Zonë e shënjuar

Modul Edukativ 3: Hedhje e kryqëzuar

Objektivi: **Përmirësim i kërcimit në litar**

Situata e propozuar: Lojra të ndryshme kërcimi me litar

Sjellja e fillestarëve: Fillestarët kanë vështirësi në koordinimin e kërcimeve me veprimin e krahëve për të rrotulluar litarin në mënyrë të vazhdueshme. Ata shpesh e mbajnë trupin e tyre përpara, duke përkulur dyfish legenin.

Udhëzime për ushtrimin:
- Mbani një qëndrim të drejtë
- Mos kërceni shumë lart nga toka

Pika të dallueshme:
- Interpretim i kërcimeve të ndryshme
- Mbajtje e trupit në pozicion vertikal
- Koordinim i mirë i krahëve me këmbët

Progresion mësimdhënës:
- Kërcim në litar i përbashkët (lidhni sprintin me zonën e kërcimit me litar, shkëputje nga toka më dy këmbë, kërcim mbi litar, rënie në tokë më dy këmbë dhe përsëri sprint)
- Punoni me intensitet dhe ritëm të ndryshueshëm
- Zhvillim drejt aktiviteteve lojrash

Siguria:
- Terren jo i rrëshqitshëm
- Litar kërcimi i përshtatshëm

Bazë materiale:
- Litar kërcimi

Modul Edukativ 4: Hedhje e kryqëzuar

Objektivi: **Kontrollimi i kërcimeve nga e djathta në të majtë dhe nga e majta në të djathtë.**

Situata e propozuar: Kërcim mbi një pengesë e vogël nga e djathta në të majtë dhe anasjelltas.

Sjellja e fillestarëve: Fillestarët kanë tendencën të kërcejnë përpara ose përmbrapa. Trupi i tyre është shpesh përkulur nga legeni.

Udhëzime për ushtrimin:
- Vështroni ku po shkojnë ata
- Përdorni krahët gjatë kërcimit

Pika të dallueshme:
- Realizim i programit
- Nuk ka më kërcime përpara ose përmbrapa

Progresion mësimdhënës:
- Varioni pengesat (gjerësi dhe lartësi gjithnjë e përshtatshme)
- Bëni një kërcim në këmbë në çdo anë të pengesës ose vetëm në një anë
- Kërceni njëkohësisht më një pjesëmarrës tjetër
- Zhvillim drejt aktiviteteve lojrash

Siguria:
- Terren jo i rrëshqitshëm
- Pengesa të përshtatshme

Bazë materiale:
- Shënjues horizontalë
- Pengesa të ndryshme

Modul Edukativ 5: Hedhje e kryqëzuar

Objektivi: **Përmirësim i kërcimeve anësore dhe përpara**

Situata e propozuar: Lidhni kërcimet duke u hedhur nga e djathta në të majtë dhe përpara përgjatë një përshkallëzuesi koordinativ të vizatuar në tokë.

Sjellja e fillestarëve: Fillestarët kanë vështirësi në memorizimin e programit të detyrueshëm. Ata shpesh kanë tendencën të humbin ekuilibrin përgjatë kërcimit përpara.



Udhëzime për ushtrimin:
- Mos e mbani shikimin te këmbët tuaja
- Kufizoni lëvizjet anësore dhe të përparme më së shumti

Pika të dallueshme:
- Realizim i ushtrimit korrektësisht
- Nuk ka lëvizje të paekuilibruara
- Përdorim i krahëve

Progresion mësimdhënës:
- Varioni format e pengesave dhe shënjuesve (gjithnjë të përshtatshme)
- Impononi ndjekjen e një ritmi
- Mbani kohën
- Orientim drejt lojrave

Siguria:
- Terren jo i rrëshqitshëm
- Pengesa/zona të përshtatshme

Bazë materiale:
- Shënjues horizontalë
- Kronometër/bilbil

MODUL EDUKATIV: KËRCIM NË LITAR

Analiza e eventit : Praktikim i koordinimit midis krahëve dhe këmbëve dhe përvetësim minimal i shkëputjes nga toka me dy këmbë. Kontrollim i shpejtësisë maksimale të lëvizjes.

Siguria e pjesëmarrësve : Ushtrimi duhet të realizohet në një terren të butë dhe jo të rrëshqitshëm. Gjatësia e litarit duhet të rregullohet në bazë te pjesëmarrësve (e barabartë me distancën nga dora në tokë kur krahu është i tendosur horizontalisht).



Event nga Kompeticion i IAAF – Atletika për Fëmijë

Modul Edukativ 1: Kërcim në Litar

Objektivi: **Eksperimentim i kërcimit në litar**

Situata e propozuar: Realizimi i kërcimeve të ndryshme në një litar të mbajtur nga dy pjesëmarrës.

Sjellja e fillestarëve: Fillestarët shpesh qëndrojnë në pozicionin e lëvizjes dhe nuk kanë ndonjë ide të saktë të trajektores së litarit. Ata shpesh kërcejnë përpara në vend që të kërcejnë vetëm lart.



Udhëzime për ushtrimin:
- Rrini përballë personit që rrotullon litarin
- Kërceni vertikalisht

Pika të dallueshme:
- Realizojnë kërcimet e kërkuara
- Koordinojnë krahët me këmbët
- Realizojnë kërcime të vogla

Progresion mësimdhënës:
- Varioni frekuencën e rrotullimit të litarit
- Varioni numrat dhe format e kërcimeve
- Hyrje/dalje nga litari nga pika të ndryshme
- Rrisni numrin e litarëve
- 2, 3 ose edhe 4 fëmijë mund të kërcejnë njëkohësisht në të njëjtin litar
- Orientohuni drejt lojrave

Siguria:
- Terren i drejtë
- Mbani gjithnjë shikimin tek ata që rrotullojnë litarin

Bazë materiale:
- Litarë kërcimi të sigurtë

Modul Edukativ 2: Kërcim në Litar

Objektivi: **Eksperimentim i koordinimit të kërcimit/kthimit**

Situata e propozuar: Mbani të dyja anët e litarit me dorën e djathtë, dhe rrotullojeni me kyçin e dorës. Shkëputni nga toka më të dyja këmbët sa herë që litari prek terrenin.

Sjellja e fillestarëve: Ata kanë vështirësi të rrotullojnë litarin dhe të kërcejnë në të njëjtën kohë dhe shpesh kërcejnë me trup të përkulur.



Udhëzime për ushtrimin:
- Filloni të rrotulloni litarin më frekuencë të vogël
- Bëni kujdes kur litari prek tokën dhe filloni të kërceni
- Litari duhet të mbahet me dorë
- Pozicion vertikal i trupit (hedhje dhe rënie)

Progresion mësimdhënës:
- Praktikoni me dorën e majtë
- Varioni frekuencën
- Organizoni sekuencat e lëvizjeve
- Për më të rriturit ose për ata që kanë më shumë koordinim, praktikoni kërcimin në litar me këmbët e tendosura (pra, praktikim vetëm i vendosjes së këmbës)
- Orientohuni drejt lojrave

Siguria:
- Terren i drejtë
- Organizimi i grupeve

Bazë materiale:
- Litar kërcimi i përshtatshëm

Modul Edukativ 3: Kërcim në Litar

Objektivi: **Eksperimentimi individual i kërcimit në litar**

Situata e propozuar: Duke mbajtur litarin pas thembrave, mundohuni të përsërisni sa më shumë kërcime të jetë e mundur me ritëm të dy kohshëm për suport.

Sjellja e fillestarëve: Fillestarët rrotullojnë litarin dhe përkulen përpara për ta kaluar atë. Ata shpesh e ndalojnë rrotullimin pas rënies.

Udhëzime për ushtrimin:
- Filloni me frekuencë të ulët
- Mbani trupin drejt

Pika të dallueshme:
- Realizojnë shumë më shumë kërcime
- Ruajnë fuqinë e tyre (zgjedhin kohën e duhur dhe nuk kërcejnë shumë lart)
- Pozicion vertikal i trupit

Progresion mësimdhënës:
- Varioni frekuencën e kërcimeve
- Kaloni litarin në çifte
- Varioni format e kërcimeve
- Gjenoroni lëvizje
- Për më të rriturit ose për ata që kanë më shumë koordinim, praktikoni kërcimin në litar me këmbët e tendosura (pra, praktikim vetëm i vendosjes së këmbës)
- Orientohuni drejt lojrave

Siguria:
- Terren i drejtë dhe jo rrëshqitës
- Organizimi në grupe

Bazë materiale:
- Litarë me gjatësi të ndryshme

Modul Edukativ 4: Kërcim në Litar

Objektivi: **Përmirësim i kërcimit në litar duke ecur**

Situata e propozuar: Fillestarët duhet të ecin duke kërcyer në litar përgjatë një distance të drejtë dhe pastaj të ndryshueshme, duke kompletuar dy hapa në mes të një rrotullim litari (hap vrapimi të lehtë).

Sjellja e fillestarëve: Fillestarët kanë vështirësi gjatë rrotullimit. Ata shpesh përkulen përpara duke përdorur shpatullat për të rrotulluar litarin.



Udhëzime për ushtrimin:
- Vraponi dhe kërceni duke mbajtur trupin në pozicion vertikal dhe të drejtë
- Shtrëngoni litarin me kyçet e dorës
- Mbani vështrimin gjithmonë përpara

Pika të dallueshme:
- Realizim i ushtrimeve në distanca të ndryshme
- Mbajtje e ritmit të vrapimit
- Qëndrim i relaksuar gjatë kryerjes së ushtrimit

Progresion mësimdhënës:
- Realizoni ushtrime me mënyra të ndryshme (me kthesa, sllallom, etj.)
- Vrapim i lehtë nga këmba e djathtë në të majtë
- Lëvizni nga kërcimi me dy këmbë në kërcimin me një këmbë
- Kaloni litarin në çifte
- Orientohuni drejt lojrave

Siguria:
- Organizimi në grupe
- Gjatësi e përshtatshme e litarit
- Zona të shënjuara për vrapim

Bazë materiale:
- Litarë
- Shënjues vertikalë

Modul Edukativ 5: Kërcim në Litar

Objektivi: **Përmirësimi i kërcimit në litar duke vrapuar drejt**

Situata e propozuar: Fillestarët duhet të ecin duke kërcyer në litar përgjatë një distance të drejtë dhe pastaj të ndryshueshme, me një suport gjatë çdo rrotullim litari (me hap galopant).

Sjellja e fillestarëve: Fillestarët kanë më shumë vështirësi të galopojnë me litar sesa të vrapojnë. Ata shpesh përkulen përpara duke përdorur shpatullat për të rrotulluar litarin.



Udhëzime për ushtrimin:
- Vraponi dhe kërceni me trupin në pozicion të drejtë dhe vertikal
- Shtrëngoni litarin me kyçet e dorës
- Mbani vështrimin gjithmonë përpara

Pika të dallueshme:
- Realizim i ushtrimeve në distanca të ndryshme
- Mbajtje e ritmit të vrapimit
- Qëndrim i relaksuar gjatë kryerjes së ushtrimit

Progresion mësimdhënës:
- Realizoni ushtrime me mënyra të ndryshme (me kthesa, sllallom, etj.)
- Ndryshoni hapin, vrap i lehtë/galop dhe galop/vrap i lehtë, pa ndalesa
- Kaloni nga kërcim me dy këmbë në hapa galopantë
- Kaloni litarin në çifte
- Orientohuni drejt lojrave

Siguria:
- Organizimi në grupe
- Gjatësi e përshtatshme e litarit
- Zona të shënjuara për vrapim

Bazë materiale:
- Litarë
- Shënjues vertikalë

MODUL EDUKATIV: KËRCIM TRE HAPËSH BRENDA NJË ZONE TË KUFIZUAR

Analiza e praktikumit të kërcimit : Kërcimi 3 hapesh brenda një zone të kufizuar kërkon një përvetësim minimal të saktësisë së vrapimit, të teknikës së kërcimit dhe të sekuencës hap/kërcim.
Praktikimi i hapit/kërcimit është efikas për zbulimin e suportit të ekuilibrit.

Siguria e pjesëmarrësve : Ka dy lloje garancish për sigurinë:
- Kryeni ushtrimin e kërcimit në një zonë të butë dhe jo të rrëshqitshme.
- Përpjekje praktike dhe direkte për përvetësimin e teknikës në fillim përpara se të punonim me performancën.



Event nga Kompeticion i IAAF – Atletika për Fëmijë

Shënim : Në çdo seancë ushtrimesh me kërcime të ndryshme, "kërcimi i rregullt" do të ketë gjithmonë prioritet.

Modul Edukativ 1: 3-Hapësh i Limituar

Objektivi: **Përmirësimi i momentit të kërcimit**

Situata e propozuar: Kryeni kërcime të përparme me vrapime të shkurtra për të përmirësuar saktësinë në zonën e suportit. Pengesat do të jenë kryesisht horizontale për të mos sforcuar pjesëmarrësit që të kryejnë kërcime të larta.

Sjellja e fillestarëve: Për të fituar saktësi, fillestarët ngadalësojnë hapin përpara zonës së kërcimit dhe shikojnë tokën duke devijuar nga sjellja normale e kërcimit.



Udhëzime për ushtrimin:
- Mos shikoni në tokë
- Lidhni fazat e kërcimit dhe të vrapimit në një sekuencë të vetme

Pika të dallueshme:
- Saktësi në vënien e këmbës së mbështetjes në tokë
- Nuk ka humbje shpejtësie përpara kërcimit
- Rënie në tokë pas kërcimit me shpejtësinë e vrapimit

Progresion mësimdhënës:
- Varioni distancat midis pengesave (mbani distancë të shkurtër deri në 10m)
- Ndryshoni gjerësinë e pengesave kur është e mundur
- Realizoni kërcimin me këmbën e djathtë dhe pastaj me të majtën
- Realizoni rënien në tokë me këmbën e djathtë pastaj me të majtën
- Orientohuni drejt lojrave

Siguria:
- Terren i butë
- Shënjues të sigurtë dhe jo të rrëshqitshëm

Bazë materiale:
- Shënjues kërcimesh
- Shënjues përgjatë pistës

*** Kjo seancë trajnimi është gjithmonë e vlefshme për vrapim të shkurtë në përgatitje të 3-hapëshit dhe kërcimit së gjati.**

Modul Edukativ 2: 3-Hapësh i Limituar

Objektivi: **Eksperimentim dhe përvetësim i teknikës së kërcimit**

Situata e propozuar: Zbuloni dhe përmirësoni teknikën e kërcimit nëpërmjet seancave të ndryshme ushtrimesh. Fillimisht, zona e kërcimit do të jetë e limituar për një realizim sa më të mirë.
Shembull : Sekuenca kërcimi përgjatë një distance të shënjuar.

Sjellja e fillestarëve: Në momentin që fillestarët ballafaqohen me problemin themelor koordinues të teknikës së kërcimit, ata shpesh humbin ekuilibër anash ndërkohë që kërcejnë pasi pesha e trupit nuk bie mbi këmbën e mbështetjes në tokë. Ata shpesh nuk koordinojnë krahët e tyre me hapat e kërcimit, gjë e cila e pengon ne ruajtjen e ekuilibrit.



Udhëzime për ushtrimin:
- Mbështetuni në suportin e terrenit
- Përdorni krahët për të lëvizur

Pika të dallueshme:
- Atleti është i aftë të kërcejë (dmth, mbështetje e mirë e këmbës në tokë)
- Atleti mban një pozicion të ekuilibruar gjatë kërcimit dhe më pas

Progresion mësimdhënës:
- Varioni pistat
- Ofroni distanca të ndryshme me një shkallë rritjeje
- Përsërisni disa kërcime
- Orientohuni drejt lojrave

Siguria:
- Terren i butë
- Pengesa të sigurta

Bazë materiale:
- Shënjues horizontalë(pengesa)
- Shënjues vertikalë(për pistën)

*** Kjo seancë trajnimi është gjithmonë e vlefshme për vrapim të shkurtë në përgatitje të 3-hapëshit dhe kërcimit së gjati.**

Modul Edukativ 3: 3-Hapësh i Limituar

Objektivi: **Eksperimentimi dhe përvetësimi i sekuencës së hapit/kërcimit pa humbje shpejtësie**

Situata e propozuar: Realizoni sekuenca hapi/kërcimi brenda hapësirash të limituara të ndryshme me shpejtësi të ndryshme.

Sjellja e fillestarëve: Fillestarët zakonisht kryejnë kërcime të vogla dhe hapa të mëdhenj. Ata shpesh devijojnë nga trajektorja e duhur e kërcimit sepse humbin ekuilibër gjatë veprimit të kërcimit. Ata nuk përdorin ose i keq përdorin segmentet e lira (krahët dhe këmbët) për të lëvizur përpara.



Udhëzime për ushtrimin:
- Mos ndaloni ndërmjet hapave dhe kërcimeve
- Mos prishni rënien gjatë kërcimit

Pika të dallueshme:
- Kryerje e sekuencës së kërcimit në pozicion të ekuilibruar
- Kryerje e sekuencës së kërcimit pa humbje shpejtësie
- Përdorim i përshtatshëm i segmenteve të lira

Progresion mësimdhënës:
- Varioni sekuencën e kërcimit (dopio hap, kërcim dhe dopio kërcim me hap, etj.)
- Kërkoni sinkronizim dhe jo sinkronizim të krahëve : njëkohësisht ose të alternuar
- Varioni pistat e praktikumit dhe distancat midis kërcimeve
- Orientohuni drejt lojrave

Siguria:
- Terren i butë
- Bazë materiale e sigurtë

Bazë materiale:
- Shënjues horizontalë
- Shënjues për pistën

*** Kjo seancë trajnimi është gjithmonë e vlefshme për vrapim të shkurtë në përgatitje të 3-hapëshit dhe kërcimit së gjati.**

Modul Edukativ 4: 3-Hapësh i Limituar

Objektivi: **Përdorim efikas i krahëve në teknikën e kërcimit**

Situata e propozuar: Duke kryer sekuenca hapi/kërcimi, mundohuni të koordinoni krahët në mënyra të ndryshme (simultane, të sinkronizuara, alternative me gjymtyrët e poshtme).

Sjellja e fillestarëve: Fillestarët kanë vështirësi të mëdha të koordinojnë lëvizjen e krahëve me çfarëdo lloj suporti. Krahët e tyre shpesh ofrojnë më shumë ekuilibër sesa aksion.



Udhëzime për ushtrimin:
- Filloni me zona kërcimi të vogla
- Praktikoni me krahë dhe shpatulla të relaksuara

Pika të dallueshme:
- Realizim i programit të kërkuar
- Ekuilibër i përgjithshëm i mirë gjatë sekuencave të kërcimit
- Efikasitet i njëjtë i të dy krahëve duke u praktikuar

Progresion mësimdhënës:
- Varioni pistat
- Varioni hapësirat
- Lidhni praktikimin alternativ me atë të sinkronizuar
- Orientohuni drejt lojrave

Siguria:
- Terren i butë
- Zona kërcimi të përshtatshme

Bazë materiale:
- Shënjues horizontalë
- Shënjues vertikalë

*** Kjo seancë trajnimi është gjithmonë e vlefshme për vrapim të shkurtë në përgatitje të 3-hapëshit dhe kërcimit së gjati.**

Modul Edukativ 5: 3-Hapësh i Limituar

Objektivi: **Caktimi i përmasave për një vrapim të shkurtër**

Situata e propozuar: Nga një distancë e shënjuar çdo 20m, pjesëmarrësi përpiqet të organizojë një vrapim të saktë në mënyrë që të kërcejë sa më afër zonës së kërcimit.

Sjellja e fillestarëve: Fillestarët kanë vështirësi të përsërisin vrapim të njëjtë. Ata janë të dobët për të rregulluar hapat e fundit në distancën e mbetur.



Udhëzime për ushtrimin :
- Ndryshoni zonën e startit deri sa të gjeni distancën tuaj të duhur
- Përpiquni të mbani të njëjtin hap vrapues nga njëra zonë në tjetrën

Pika të dallueshme:
- Shkëputje për kërcim i saktë
- Rënie në tokë me këmbën e shkëputjes
- Nuk ngadalësojnë shpejtësinë pranë zonës së kërcimit

Progresion mësimdhënës:
- Ndryshoni lehtësisht hapësirat e propozuara
- Vendosni shënjues të ndërmjetshëm në mesin e zonës

Siguria:
- Zonë rënie e butë
- Grup i organizuar
- Zona vrapimi të përshtatshme

Bazë materiale:
- Shënjues
- Regjistrues

*** Kjo seancë trajnimi është gjithmonë e vlefshme për vrapim të shkurtë në përgatitje të 3-hapëshit dhe kërcimit së gjati.**

MODUL EDUKATIV: HEDHJE SHTIZE PËR FËMIJË

Analiza e situatës: Eventi i hedhjes kërkon komandimin e trajektores dhe performancës me një krah të tendosur pas një vrapi të shkurtër.

Siguria e pjesëmarrësve: Pajisjet dhe objektivi i precizionit duhet të rregullojnë problemin e sigurisë. Gjithsesi, rekomandohet që të organizohen grupet, koha dhe hapësira për të paralajmëruar pjesëmarrësit për rregullat e sigurisë gjatë seancës së hedhjes.



Event nga Kompeticion i IAAF – Atletika për Fëmijë

Modul Edukativ 1: Hedhje Shtize për Fëmijë

Objektivi: **Eksperimentim i hedhjes me një krah të tendosur**

Situata e propozuar: Hidhni një mjet të sigurtë dhe të lehtë (0,5kg maksimumi) drejt shënjestrës me një krah, nga një pozicion statik duke mbajtur këmbët paralele. Krahu i hedhjes duhet të mbahet në lartësi mbi nivelin e shpatullës.

Sjellja e fillestarëve: Fillestarët kryejnë lëvizje dhe kthime të trupit, të cilat janë të dëmshme për preciozionin e hedhjes.



Udhëzime për ushtrimin:
- Mbani bustin e trupit në një vijë të drejtë
- Mbani trupin dhe shikimin drejt dhe përballe shënjestrës
- Krahu i hedhjes qëndron mbi shpatull

Pika të dallueshme:
- Pozicion korrekt i trupit (legeni është i fiksuar)
- Mbajtje e krahut mbi nivelin horizontal të shpatullës
- Përdorim i elasticitetit të shpatullës

Progresion mësimdhënës:
- Varioni mjetet e lehta për hedhje
- Varioni shënjestrat
- Kryeni ushtrimin si lojra individuale ose kolektive

Siguria:
- Përdorni mjete të sigurta
- Organizimi i grupeve
- Organizimi i vrapimit të ushtrimit

Bazë materiale:
- Mjete të ndryshme për hedhje
- Shënjestra

Modul Edukativ 2: Hedhje Shtize për Fëmijë

Objektivi: **Përmirësimi i komandës së vrapimit**

Situata e propozuar: Pas 3 hapave të lehtë kryeni një hedhje me duar të një topi futbolli ose të një topi te lehtë mjekësor.

Sjellja e fillestarëve: Fillestarët do të ndalojnë përpara hedhjes dhe legeni i tyre do të lëvizë në të kundërt pas momentit të hedhjes së topit.



Udhëzime për ushtrimin:
- Hidheni duke u mbështetur në këmbën e majtë
- Mbani topin lart mbi kokë

Pika të dallueshme:
- Mos ndaloni gjatë hedhjes
- Lëvizni përpara pas hedhjes
- Mbani shikimin drejt përpara
- Mbani duart lart mbi kokë

Progresion mësimdhënës:
- Varioni trajektoret (high, loë, straight, etc.)
- Praktikoni hedhjen nga të dy krahët
- Orientohuni drejt lojrave

Siguria:
- Përdorni mjete të sigurta
- Organizimi i grupeve
- Organizimi i ushtrimit të vrapimit
- Terren i sheshtë

Bazë materiale:
- Mjete të ndryshme për hedhje
- Shënjestra

Modul Edukativ 3: Hedhje Shtize për Fëmijë

Objektivi: **Precizioni i Trajektores**

Situata e propozuar: Pas disa hapave, kryeni një sekuencë prej 3 hedhjesh në shënjestër me një krah të tendosur të disa objekteve të ndryshme: ose hidhni 3 objekte të njëjtë në tre shënjestra të ndryshme (pesha e objekteve është maksimumi 0,5kg).

Sjellja e fillestarëve: Fillestarët kanë vështirësi në rregullimin e hedhjes me kushtet e rejas (pajisjet; distanca): pasaktësi e madhe në këtë praktikim hedhjeje.



Udhëzime për ushtrimin:
- Mos deformoni trupin gjatë hedhjes
- Mbani shikimin drejt shënjestrës

Pika të dallueshme:
- Arritje e shënjestrës
- Mbajtje e shikimit drejt hedhjes
- Nuk ndalojnë para se të kryejnë hedhjen
- Lëvizin përpara pas hedhjes

Progresion mësimdhënës:
- Varioni format e hedhjes
- Varioni shënjestrat
- Varioni sekuencat
- Orientohuni drejt lojrave

Siguria:
- Përdorni mjete të sigurta
- Organizimi i grupeve
- Organizimi i ushtrimit të vrapimit
- Terren i sheshtë

Bazë materiale:
- Mjete të ndryshme për hedhje
- Shënjestra

Modul Edukativ 4: Hedhje Shtize për Fëmijë

Objektivi: **Eksperimentim i vrapimit me hapa të kryqëzuar**

Situata e propozuar: Pjesëmarrësit kryejnë sekuenca më distanca të ndryshme në pozicion anësor duke mbajtur në dorë një shtizë për fëmijë.

Sjellja e fillestarëve: Hapat e kryqëzuar janë të panjohur për fillestarët të cilët kanë vështirësi në hedhjen dhe rregullimin e hapave të tyre, veçanërisht nga këmba më pak e përdorshme. Ata do të harrojnë komplet të kontrollojnë shtizën (Shtiza lëkundet sa në një anë në një tjetër dhe humbet drejtimin e hedhjes).



Udhëzime për ushtrimin:
- Mbani shtizën në drejtimin e hedhjes
- Mundohuni të kryeni hapa efikasë

Pika të dallueshme:
- Kryerje e hapave të kryqëzuar me lehtësi
- Shtiza është e palëkundur dhe në drejtim të hedhjes

Progresion mësimdhënës:
- Varioni distancat
- Përdorni shtiza më të gjata

Siguria:
- Organizimi i grupeve
- Shënjues të qartë në zonën e hedhjes

Bazë materiale:
- Shtiza të ndryshme
- Shënjues vertikalë

Modul Edukativ 5: Hedhje Shtize për Fëmijë

Objektivi: **Organizimi i eventit të hedhjes pas një vrapi të shkurtër**

Situata e propozuar: Kryeni një vrapim për hedhje në një zonë të shënjuar: vrapim i shkurtër prej 5m, shënjestra do jetë në një distancë prej 10, 15, ose 20-m (pajisje të lehta prej maksimumi 0,5kg).

Sjellja e fillestarëve: Fillestarët e kanë të vështirë të lidhin vrapimin dhe hedhjen në një lëvizje të vetme. Vrapimi anësor ndërhyn paksa në saktësinë e trajektores.



Udhëzime për ushtrimin:
- Kryeni një vrapim të rregullt
- Në fazën e hedhjes, qëndroni përballë shënjestrës

Pika të dallueshme:
- Trajektore të sakta
- Kalim i peshës në këmbën e mbështetjes, trupi zhvendoset përpara drejt drejtimit të hedhjes
- Shtiza hidhet lart zonës së hedhjes dhe trupi është në pozicion të drejtë

Progresion mësimdhënës:
- Varioni distancat e shënjestrave
- Varioni shtizat

Siguria:
- Organizimi i grupeve
- Zonë e shënjuar

Bazë materiale:
- Shtiza të ndryshme
- Shënjues vertikalë

MODUL EDUKATIV: HEDHJE NGA POZICIONI NË GJUNJË

Analiza e situatës: Kjo hedhje u mundëson atletëve të rinj që nga një pozicion i lehtë të eksperimentojnë forcën e përcjellë nga ija dhe nga kushti paraprak i tendosjes së shaptullave.

Siguria e pjesëmarrësve: Atletët bien në gjunjë në një sipërfaqe toke të butë, (një rrogoz, rërë, bar). Përshtat peshën e topit "mjekësor", zgjidh gjithmonë më të lehtin, (1 kg, 1.5kg).

Figurë



Event nga Kompeticion i IAAF – Atletika për Fëmijë

Moduli edukativ 1: Hedhje nga pozicioni në gjunjë

Objektivi: **Të eksperimentosh aktivitetet e hedhjes nga çdo pozicion përveç të qëndruarit në këmbë.**

Situatë e propozuar: Nga një pozicion ulur në një zbatim të sipërm. Lëviz gjysmën e sipërme të trupit për të filluar përshpejtimin e një objekti të hedhur drejt një shënjestre (një mjet i lehtë, maksimumi 1 kg).

Sjellja e fillestarëve: Fillestarët shpesh e kërkojnë energjinë e tyre me deformimin e lëvizjeve të trupit. Kjo është e dëmshme për saktësinë e hedhjes.



Udhëzime për ushtrimin:
-Të ulesh në një vend të balancuar/ të qëndrueshëm.
-Mbaji fortë mjetet e hedhjes.

Pika për t'u vënë re:
-Boshti fillon një nxitim të gjatë dhe të vazhdueshëm.
-Kordino boshtin/krahët.
-Trajektore të sakta.

Progresion mësimdhënës:
-Ndrysho mjetet.
-Ndrysho distancat dhe trajektoret.
-Ndrysho pozicionin e hedhjes së objektit. (lart, në nivelin e kraharorit, nga anët e djathtë/ e majtë).
-Vazhdimi i ushtrimeve si lojëra individuale dhe kolektive.

Siguria:
-"Ndenjëse" të qëndrueshme.
-Organizo grupin.
-Objekte hedhëse të sigurta.
-Prioritet i jepet saktësisë.

Bazë matëriale:
-Ndenjëse.
-Mjete të ndryshme hedhëse.
-Objekte.

Moduli edukativ 2: Hedhje nga pozicioni në gjunjë

Objektivi: **Të përmirësosh mekanizmin e hedhjes me pjesën e sipërme të trupit.**

Situatë e propozuar: Gjunjëzim mbi njërin gju, lëviz gjysmën e sipërme të trupit për të filluar nxitimin e një objekti të hedhur në një plan (përdor një mjet të lehtë, maksimumi 1 kg).

Sjellja e fillestarëve: Fillestarët gjithmonë humbasin balancën gjatë hedhjes.



Udhëzime për ushtrimin:
-Mbaj një pozicion të balancuar mirë.
-Blloko legenin gjatë hedhjes.

Pika për t'u vënë re:
-Boshti fillon një nxitim të gjatë dhe të vazhdueshëm.
-Koordinim i bustit/ i krahëve.
-Trajektore të sakta.

Progresion mësimdhënës:
-Ndrysho mjetet.
-Ndrysho distancat dhe trajektoret.
-Ndrysho pozicionin e objektit të hedhur
(lart, në nivelin e kraharorit, nga anët e djathta/ të majta).
-Procedoi ushtrimet më shumë si lojra

Siguria:
-Tokë e butë për pozicionin e gjunjëzimit.
-Organizo grupin.
-Mjete të sigurta hedhëse.
-Prioritet i jepet saktësisë.

Bazë matëriale:
-Rrugicë po është e nevojshme.
-Mjete hedhëse të ndryshme.
-Objekte.

Moduli edukativ 3: Hedhje nga pozicioni në gjunjë

Objektivi: **Të mësosh se si të gjeneroshosh forcë me gjymtyrët e poshtëm.**

Situatë e propozuar: Të fillosh nga një pozicion ulur, pjesëmarrësit duhet të lëvizin gjunjët e tyre përpara dhe të bëjnë një hedhje me veprimin e gjymtyrëve të tyre të poshtëm (mjet, maksimumi 2 kg).

Sjellja e fillestarëve: Fillestarët shpesh parashikojnë veprimin e krahëve të tyre. Pjesën më të madhe të kohës ata bëjnë të detyrueshme një lëvizje prapa nga legeni, gjatë shtrirjes së trupit.



Udhëzime për ushtrimin:
-Hidh pas lëvizjes së këmbëve.
-Humb ekuilibrin përpara.

Pika për t'u vënë re:
-Bëj lëvizjen e gjunjëve përpara që të pozicionosh legenin.
-Ec me këmbët.
-Koordino veprimin e krahëve.
-Mbaje legenin në një pozicion të fortë duke gjeneruar forcë.

Progresion mësimdhënës:
-Ndrysho lartësinë fillestare.
-Ndrysho mjetet.
-Ndrysho format e hedhjes.

Siguria:
-Përshtat topin mjekësor.
-Jo tokë rrëshqitëse.
-Organizimi i grupit.

Bazë matëriale:
-Një top mjekësor.
-Pajisjet e uljes.

Moduli edukativ 4 : Hedhje nga pozicioni në gjunjë

Objektivi: **Të provosh forma të ndryshme të të hedhurit nga pozicionet e gjunjëzimit dhe të uljes.**

Situatë e propozuar: Nga pozicioni i gjunjëzimit kryej hedhje të objekteve të ndryshme të përshtatshme. Hedhjet janë arritur nga shpatulla e majtë, pastaj e djathta, nga kraharori, nga një lëvizje rrotulluese në e djathta dhe të majtë, nga krahu i shtrirë (hedhje objektesh të peshave të ndryshme që varen nga forma, por gjithmonë maksimumi 1 kg).

Sjellja e fillestarëve: Fillestarët s'mund të arrijnë ndonjë hedhje të efektshme për shkak se ata nuk i përdorin kofshët dhe legenin e tyre për të lëvizur objektin që hidhet.



Udhëzime për ushtrimin:
-Blloko legenin.
-Gjenero nxitim nga një anë e pozicionit prapa dhe lëviz përpara.

Pika për t'u vënë re:
-Mos u rrëzo gjatë hedhjes.
-Humb balancën përpara, pas hedhjes.
-Menaxho që të hedhësh për lartë.

Progresion mësimdhënës:
-Ndrysho objektet hedhëse (forma, pesha).
-Ndrysho llojin e objekteve.
-Lëviz drejt lojrave.

Siguria:
-Tokë e butë për pozicionin e gjunjëzimit.
-Objekte të sigurta hedhjeje.

Bazë matëriale:
-Mjete të ndryshme.
-Një objektiv.

Moduli edukativ 5 : Hedhje nga pozicioni në gjunjë

Objektivi: **Të jesh në gjendje të drejtosh trajektoret nga një pozicion gjunjëzimi dhe uljeje.**

Situatë e propozuar: Nga një pozicion gjunjëzimi ose uljeje hidh objekte të ngjashme ose të ndryshme drejt planeve të vendosur në distanca në rritje. Në rastin e hedhjeve rrotulluese, zhvendos objektin hedhës së dorës së djathtë pak në të majtë të planit (përdor objekte të ndryshme gjithmonë maksimumi 1 kg).

Sjellja e fillestarëve: Fillestarët nuk qëndrojnë në një pozicion të qëndrueshëm nga njëra hedhje në tjetërën(rënie të ndryshme, lëvizje të prapme të shpatullave, etj.). Ata e kanë të vështirë të jenë të saktë.



Udhëzime për ushtrimin:
-Qëndro në një pozicion të fortë gjatë hedhjes.
-Shiko në drejtim të planit.
-Pas dorëzimit, shpatulla/shikimi përballë me objektivin.

Pika për t'u vënë re:
-Të arrish ushtrimin e kërkuar.
-Në fazën e rimëkëmbjes, qëndro në një pozicion stabël ose jo të ekuilibruar në drejtim të hedhjes.
-Krijo kufizime trajektoresh lartë.

Progresion mësimdhënës:
-Ndrysho mjetet dhe llojin.
-Ndrysho distancën.
-Ndrysho rregullin e planit.

Siguria:
-Mjete të sigurta.
-Organizim i grupit.
-Prioritet i jepet saktësisë përpara distancës.

Bazë matëriale:
-Mjete të ndryshme.
-Rrogoze ose ulëse.
-Objektiva.

Analiza e situatës: Hidh një mjet të lehtë te një plan. Kontrollo ekuilibrin, kontrollo lirinë e veprimit dhe intesitetin.

Siguria e pjesëmarrësve: Të zgjedhësh mjete të sigurta hedhjeje dhe të organizosh grupin për praktikën e hedhjes mund të jetë mënyra më e mirë për të reduktuar rrezikun në pjesën më të madhe.



Event nga Kompeticion i IAAF – Atletika për Fëmijë

Moduli Edukativ 1: Hedhje me Preçizion

Objektivi: **Për të përmirësuar preçizionin dhe rregullsinë e hedhjeve**

Situata e propozuar: Për të përgatitur eventin çdo praktikë e hedhjes së objektit do të jetë me përfitim. Ndryshimi dhe përsëritja e ushtrimeve në mënyrë të nevojshme kushtëzon një progresion.

Sjellja e fillestarëve: Fillestarët do të jenë të ngathët për shkak të lëvizjeve të deformuara të trupit të tyre dhe për shkak të një komandimi të keq të tensionit muksular.



Udhëzime për ushtrimin:
-Kontrollo fuqinë e trupit.
-Shiko te performanca e arritur.

Pika për t'u vënë re:
-Preçizion në veprimet e hedhjes.
-Trupi qëndron në pozicion të drejtë pas shpërndarjes.

Progresion mësimdhënës:
-Mjete të ndryshme.
-Objekte të larta, të ulëta, mesatare.
-Ndrysho mjetet në praktikën e hedhjes.
-Ndrysho planet në praktikën e hedhjes.
-Kryej hedhje në rritje, në zbritje ose të rastësishme
-Lëviz drejt lojrave.

Siguria:
-Organizimi i grupit.
-Mjete të sigurta hedhjeje.

Bazë materiale:
-Mjete të ndryshme hedhjeje.
-Plane të ndryshme.

Moduli Edukativ 2: Hedhje me Preçizion

Objektivi: **Të jesh në gjëndje të hedhësh mjete të ndryshme në plane të ndryshme me saktësi.**

Situata e propozuar: Atletëve të rinj u ofrohet të praktikojnë hedhjen e planit, me mjete të ndryshme hedhjeje dhe shumë plane. Hedhësi do të zgjedhë planet sipas mjeteve në dispozicion të tij/saj.

Sjellja e fillestarëve: Fillestarët do të jenë të ngathët për shkak të lëvizjeve të deformuara të trupit të tij/të saj dhe për shkak të një komandimi të keq të tensionit muksular.



Udhëzime për ushtrimin:
-Kontrollo energjinë e trupit.
-Shiko te performanca e arritur.
-Zgjidh me kujdes planet sipas mjeteve ruajtura

Pika për t'u vënë re:
-Preçizion në veprimet e hedhjes.
-Pas hedhjes trupi qëndron në vijë dhe përballë planit.

Progresion mësimdhënës:
-Mjete të ndryshme.
-Objekte të larta, të ulëta, mesatare.
-Ndrysho mjetet në praktikën e hedhjes.
-Ndrysho planet në praktikën e hedhjes.
-Lëviz drejt lojrave.

Siguria:
-Organizimi i grupit.
-Mjete të sigurta hedhjeje.

Bazë materiale:
-Mjete të ndryshme hedhjeje.
-Plane të ndryshme.

Moduli Edukativ 3: Hedhje me Preçizion

Objektivi: **Të jesh në gjendje të hedhësh mjete të ngjashme në plane të ndryshme.**

Situata e propozuar: Fëmijët duhet të kryejnë disa sekuenca hedhjeje të mjeteve të ngjashme në plane të detyrueshme duke luajtur me distanca të ndryshme (+-, -+, =+, etc.).

Sjellja e fillestarëve: Fillestarët do të jenë të ngathët për shkak të lëvizjeve të deformuara të trupit të tij/të saj dhe për shkak të një komandimi të keq të tensionit muksular.



Udhëzime për ushtrimin:
-Respekto udhëzimet për planet.
-Kontrollo energjinë e trupit.
-Shiko te performanca e arritur.

Pika për t'u vënë re:
-Preçizion në veprimet e hedhjes.
-Trupi është në vijë pas shpërndarjes.

Progresion mësimdhënës:
-Kryej hedhje në rritje, në zbritje ose hedhje të rastësishme (123, 321, 132,etj.)
-Lëviz drejt lojrave

Siguria:
-Organizimi i grupit.
-Mjete të sigurta hedhjeje.

Bazë materiale:
-Mjete të ndryshme hedhjeje.
-Plane të ndryshme.

Moduli Edukativ 4: Hedhje me Preçizion

Objektivi: **Të përmirësosh saktësinë e hedhjes nga pozicione shumë të qëndrueshme.**

Situata e propozuar: Nga një pozicion uljeje ose gjunjëzimi, fillestarët duhet të hedhin mjete të ndryshme (të ndryshme nga, pesha= 1 kg maksimumi) në plane të ndryshme.

Sjellja e fillestarëve: Fillestarët do të jenë të ngathët për shkak të lëvizjeve të deformuara të trupit të tij/të saj dhe për shkak të një komandimi të keq të tensionit muskular.

Udhëzime për ushtrimin:
-Kontrollo forcën e kraharorit.
-Shiko te performanca e arritur.

Pika për t'u vënë re:
-Preçizion në veprimet e hedhjes.
-Kraharori është përballë planit pas shpërndarjes.

Progresion mësimdhënës:
-Mjete të ndryshme.
-Plane të larta, të ulëta, mesatare.
-Ndrysho mjetet në praktikën e hedhjes.
-Ndrysho planet në praktikën e hedhjes.
-Kryej hedhje në rritje, në ulje ose të rastësishme
-Për hedhjet rrotulluese, zhvendos hedhësen e dorës së djathtë në të majtë të planeve (Anasjelltas për hedhësen e dorës së majtë)
-Lëviz drejt lojrave.

Siguria:
-Organizimi i grupit.
-Mjete të sigurta hedhjeje.
-Një pengesë, një karrige, një stol etj.

Bazë materiale:
-Mjete të ndryshme hedhjeje.
-Plane të ndryshme.

Moduli Edukativ 5: Hedhje me Preçizion

Objektivi:**Hedhje preçize me hapa ecjeje**

Situata e propozuar: Pas disa hapash ecjeje fillestarët do u duhet të hedhin mjete të ndryshme (të ndryshme nga, pesha = 1kg maksimumi) nga pozicione të ndryshme në plane të ndryshme.

Sjellja e fillestarëve: Fillestarët do të jenë të ngathët për shkak të lëvizjeve të deformuara të trupit të tij/të saj dhe për shkak të një komandimi të keq të tensionit muksular.



Udhëzime për ushtrimin:
-Kontrollo balancën pas shpërndarjes.
-Shiko te performanca e arritur.

Pika për t'u vënë re:
-Saktësi në veprime.
-Balancë në fazën e shpërndarjes.
-Kraharori/sytë janë përballë planit pas shpërndarjes.

Progresion mësimdhënës:
-Mjete të ndryshme, distance të ndryshme.
-Ndrysho mjetet në praktikën e hedhjes.
-Për hedhjet rrotulluese, zhvendos zhvendos hedhësen e dorës së djathtë në të majtë të planeve (Anasjelltas për hedhësen e dorës së majtë)

Siguria:
-Organizimi i grupit.
-Mjete të sigurta hedhjeje.

Bazë materiale:
-Mjete të ndryshme hedhjeje.
-Plane të ndryshme.

Moduli edukativ: Rezistencë progresive

Analiza e situatës: Kursi i propozuar thekson kontrollin e shpejtësisë dhe aftësitë aerobike të pjesëmarrësve. Eventi kërkon një strategji të sigurtë që të zbatohet në fillim të garës.

Udhëzime për sigurinë e pjesëmarrësve: Jo rrezik në kursin e propozuar, shpjegim shterues përpara se eventi të fillojë.



Figurë.

Hapje e portës: 5' përsa i përket planifikimit të eventit.



Shënim: Këto module edukative janë gjithashtu të vlefshme për eventin "1000m Rezistencë" për 11/12 vjeçarët, të cilëve nuk u duhet të ndjekin një trajnim program specifik.

Modul Edukativ 1: Rezistencë progresive

Objektivi: **Të përmirësosh komandimin e shpejtësisë së vrapit.**

Situata e propozuar: Mbi distancat relativisht të shkurtra (nga 50 deri në 200 m) pjesëmarrësit kryejnë "kontratat e shpejtësisë".Mjeshtëri delikate e nocioneve të mëposhtme: shko më shpejtë, më ngadalë.

Sjellja e fillestarëve: Fillestarët kanë vështirësi në kontrollin e saktë të niveleve të shpejtësisë. Ata shpesh priren të vrapojnë shumë shpejtë ose shumë ngadalë.

Udhëzime për këtë event:
-Merr frymë rregullisht.
-Ji shumë i relaksuar gjatë vrapimit.

Pika për t'u vënë re:
-Respekto kontratat e shpejtësisë.
-Mbaj një hap të rregullt.
-Saktëso vrapimin teknik.
-Kontroll i frymëmarrjes.

Progresion mësimdhënës:
-Ndrysho distancat dhenivelet e shpejtësisë.
-Në një kohë të dhënë, realizo distanca të ndryshme në sipërfaqe të ngushta(për shembull, korsitë e një rruge)
-Vrapo përreth drejtimesh të ndryshme (me brigje etj.)
-Lëviz drejt lojrave.

Siguria:
-Kontroll zemre.
-Përshtat shpejtësinë dhe rivendosjen.

Bazë materiale:
- Kronometër.
- Shënjues.
- Një shirit matës.

Modul Edukativ 2 : Rezistencë progresive

Objektivi: **Të kontrollosh një sekuencë të niveleve të ndryshme të shpejtësisë.**

Situata e propozuar: Kemi bashkimet e shtrirjeve të distancave në ritme të ndryshme dhe specifike. Për të lehtësuar organizimin, është më mirë të plotësosh distanca të ndryshme në një kohë të dhënë, të pandryshueshme. (shembull: vraponi bashkë 40m në 15" dhe 30m në 15" (mbi një sipërfaqe drejtëkëndëshe).

Sjellja e fillestarëve: Fillestarët kanë vështirësi në kontrollimin e ritmit të tyre gjatë distancës. Ata shpesh presin për sinjalin e fillimit në nivelin e subjektit, që të fillojnë të vrapojnë përsëri. Këto ndryshime të ritmit janë shpesh shumë të papritura dhe me një kosto të lartë në energji.



Udhëzime për ushtrimin:
- Të arrish ndryshime progresive të ritmit.
- Të jesh i relaksuar ndërkohë që vrapon.

Pika për t'u vënë re:
- Drejto kontratat e shpejtësisë.
- Vazhdo të marrësh frymë me lehtësi.
- Kërko të kursesh energji.

Progresion mësimdhënës:
- Ndrysho ritmet dhe distancat e vrapimit.
- Përmbush sekuencat progresive dhe ato në rënie, etj.
- Lëviz drejt lojrave (eksperimento: me çfarë ritmi do të vrapojnë ato?)

Siguria:

- Kurse të sigurta.
- Ritëm i përshtatur.

Bazë materiale:

- Shënues vertikal.
- Një kronometër / një bilbil.

Modul Edukativ 3 : Rezistencë progresive

Objektivi: **Të përmirësosh aftësitë aerobike të dikujt.**

Situata e propozuar: Sipas pikëve të fituara në eventin e mësipërm vrapo përgjatë distancës në 1' deri në 3' me një shpejtësi ekuivalente (ose të afërt) me shpejtësinë e regjistruar për provën 6m. Gjithmonë siguro moment për të marrë veten të paktën për aq sa është kohëzgjatja e garës, edhe një herë sa gjysma e kohëzgjatjes së garës për më shumë siguri.

Sjellja e fillestarëve: Fillestarët kanë vështirësi të vrapojnë në mënyrë të rregullt në një ritëm të ndryshëm nga ritmi i tyre individual.



Udhëzime për ushtrimin:
- Mbaje frymëmarrjen nën kontroll.
- Vrapo në një mënyrë të zakonshme dhe relaksuese.

Pika për t'u vënë re:
- Respekto kontratën.
- Ruaj një vrapim të mirë teknik.
- Rifillo sekuencën e vrapimit me një rimëkëmbje minimale (frymëmarrje të lehtë).

Progresion mësimdhënës:
- Ndrysho sekuencat e vrapit.
- Mat normën e pulsit gjatë fazave të rimëkëmbjes.
- Vrapo në sipërfaqe të ndryshme.
- Lëviz drejt lojrave.

Siguria:
- Përshtat ritmin dhe rimëkëmbjen.
- Kontroll i zemrës.

Bazë materiale:
- Shënjues, një shirit matës.
- Kronometra.

Modul Edukativ 4 : Rezistencë progresive

Objektivi: **Të kontrollosh ritmin e dikujt në trajektore dhe distanca të ndryshme.**

Situata e propozuar: E siguron atletin me orientime të ndryshme (në brigje, ngjitje dhe zbritje shpatesh, etj.), në të cilat ai/ ajo do duhet të kontrolloj shpejtësinë e tij/ e saj (më shpejtë, më ngadalë etj.)

Sjellja e fillesatrëve: Përballje me pikë referimet e ndryshme, fillestarët do të kenë vështirësi në kontrollimin e nocioneve të mëposhtme "shko më shpejtë"/ "më ngadalë". Reagimi i tyre shpesh do të jetë të shkojnë nga një ekstrem në tjetrin (shumë më ngadalë, shumë më shpejtë).



Udhëzime për këtë event:
- Të ndjesh thellë ritmin e dikujt.
- Të dëgjosh frymëmarrjen e dikujt.
- Vrapo në mënyrën më të rregullt të mundshme, në vend që të ndryshosh natyrën e drejtimit.

Pika për t'u vënë re:
- Respektimi i kontratave.
- Frymëmarrje e lehtë.
- Orientim i qetë në kuptimin e ritmit.

Progresion mësimdhënës:
- Ndrysho drejtimet.
- Lëviz drejt lojrave (pasim, etj.)

Siguria:
- Orientim i sigurtë.
- Përshtatje e programit të garës.

Bazë materiale:
- Shënues vertical.
- Një kronometër/ portë rrjete.

Modul Edukativ 5 : Rezistencë progresive

Objektivi: **Të zotërosh eventin e garës së rezistencës.**

Situata e propozuar: Në formën e një takimi në termat e organizimit, atleti do të përballet me një gamë të larmishme progrmesh vrapimi.

Sjellja e fillestarëve: Filllestarët shpesh kanë vështirësi në kontrollimin me saktësi të ritmit të tyre Ata shpesh arrijnë shumë shpejt në portë dhe për këtë arsye pengojnë rezultatin e tyre për eventin.



Udhëzime për ushtrimin:
- Vrapo rregullisht për të kursyer energji.
- Të marrësh frymë në mënyrë të rregullt.
- Të asimilosh programin e garës (më shpejt, shumë më shpejt etj.).

Pika për t'u vënë re:
- Mbërritje të rregulluara në portën e hapjes.
- Frymëmarrje e lehtë.
- Ritëm i rregullt.

Progresion mësimdhënës:
- Diversitet programesh.
- Progresion drejt lojrave.

Siguria:
- Orientim i sigurtë.
- Program vrapimi i përshtatur.

Bazë materiale:
- Shënues vertikal.
- Një kronometër / portë rrjete.

MODUL EDUKATIV: SPRINT/PENGESA-SLLALLOM-SHKËPUTJE-STAFETË

Analizë e situatës: Eventi i sprintit kërkon:

-Rregullimet në dysheme dhe distance me zigzage dhe pengesa
-Zotërimin e kalimit të pengesave në të dyja anët.
-Kontrollin e segmenteve të sipërme, të lira.

Siguria e pjesëmarrësve: Përzgjedhja e pengesave dhe e një toke të butë do të zgjidhë shumicën e problemeve të sigurisë. Të praktikuarit dhe trajnimi është çelësi për siguri, gjithashtu.



Event nga Kompeticion i IAAF – Atletika për Fëmijë

Moduli Edukativ 1: Sprint/Pengesa-Sllallom-Shkëputje-Stafetë

Objektivi: **Të përmirësosh zotërimin e kalimit të pengesave**

Situatë e propozuar: Mbi një kurs, duke ndjekur një trajektore të pjerrët, pjesëmarrësit hedhin hapa përmes pengesash të ulëta nga njëra anë në tjetrën (të djathtë dhe të majtë) madje edhe me një numër hapash të ndërmjetëm.

Sjellja e fillestarëve: Fillestarët do të zgjasin këmbën drejtuse përpara. Ulja pas kalimit të pengesave është kryer në një pozicion të sigurtë (prekin të dyja këmbët).



Udhëzime për ushtrimin:

- Vrapo në mënyrë sa më të natyrshme që të jetë e mundur.
- Mos i përdor krahët e tu për ekuilibër.

Pika për t'u vënë re:

- Bashko sprint/kalim pengesash
- Performancë e saktë në të dyja anët.
- Përdorimi korrekt i segmenteve të lirë (afër teknikës së sprintit)
- Veprim i menjëhershëm vrapimi pas kalimit të pengesave

Progresion mësimdhënës:

- Eksperimento një ritëm prej 2 hapash të rregullt në të dyja anët.
- Praktiko ushtrimin në një pozicion në një qëndrim lartë
- Praktiko kërcimin për së larti (pengesa) kërcimin përpara (ujë).
- Eksperimento ushtrimin me intervale jo të rregullta midis pengesave (në rritje, në zbritje, të rastësishme)
- Evolucion drejt lojrave individuale dhe lojrave kolektive

Siguria:

- Jo tokë të rrëshqitshme
- Shenjues të sigurtë
- Organizimi i grupit

Bazë matëriale:

- Shenjues vertikal përgjatë kursit
- Shenjues horizontal

Moduli edukativ 2: Sprint/Pengesa-Sllallom-Shkëputje-Stafetë

Objektivi: **Kontrolli i teknikës së zigzageve**

Situatë e propozuar:Sprinit me zigzage në një kurs të ndryshëm duke u imponuar pjesëmarrëseve të kryejnë një sekuencë zigzagesh e rrezesh të ndryshme ose të zakonshëm.

Sjellja e fillestarëve:
Të përballësh drejtimin e majtë dhe drejtimin e djathtë, fillestarët arrijnë ushtrimin e zigzageve. Ata shpesh modifikojnë ritmin e tyre që të jenë në gjendje të devijojnë (support i dyfishtë, etj.)



Udhëzime për ushtrimin
- Qëndro përballë drejtimit të vrapimit
- Mos e ndrysho ritmin tënd

Pika për t'u vënë re:
- Mbaj shpejtësinë e vrapimit dhe qëndro përpara drejtimit të vrapimit.
- Luaj me këndet midis trupit dhe drejtimeve të djathë e të majtë
- Mbaj veprimin e lëvizjes së krahëve (jo veprim të balancuar)

Progresion mësimdhënnës:
- Eksperimento zigzaget simetrike.
- Praktiko zigzaget në të djathë dhe në të majtë
- Eksperimento kurset në elips, në figurën e tetë, në rreth, etj.
- Praktiko vrapimet anësore (në të djathtë dhe në të majtë, madje edhe mbrapa)
- Evoluim drejt lojrave

Siguri:
- Jo tokë e rrëshqitshme
- Shenjues të sigurtë

Bazë matëriale:
- Shenjues vertikal

Moduli edukativ 3: Sprint/Pengesa-Sllallom-Shkëputje-Stafetë

Objektivi: **Të përmirësosh trajtimin e stafetës**

Situatë e propozuar: Sekuenca kalimi me mjete të ndryshme në një pozicion statik ose dinamik

Sjellja e fillestarëve: Fillestarët shikojnë te dirigjimi për të siguruar një kalim të mirë dhe shpesh ngadalësojnë ose ndalojnë për ndryshimin.



Udhëzime për ushtrimin:

- Zgjidh me kujdes krahun marrës
- Fol me partnerin tënd

Pika për t'u vënë re:

- Mos i lër mjetet të bien
- Jo humbje shpejtësie gjatë kalimit
- Kontrolli i shkëmbimeve (dhënie dhe marrje veprimesh) me të dyja duart
- Përçarje në minimum në lëvizjen ciklike të krahëve për ndryshimin

Progresin mësimdhënës:

- Shumëllojshmëri mjetesh(të vogla, të mëdha, të gjata, rreth, etj.)
- Eksperimento pozicionin dinamik të vrapuesit hyrës dhe të vrapuesit dalës, pastaj të të dyve.
- Praktiko vendosjen e dorës së djathtë dhe dorës së majtë në të dy pozicionet
- Evoluim drejt lojrave (forma të ndryshme stafetash)

Siguria:

- Organizim i grupit
- Stafeta të sigurta

Bazë matëriale:

- Stafeta të ndryshme
- Shenjues vertikal

Moduli edukativ 4: Sprint/Pengesa-Sllallom-Shkëputje-Stafetë

Objektivi: **Të kontrollosh kalimin e pengesave anësore me këmbën e djathtë dhe këmbën e majtë.**

Situatë e propozua: U propozohet pjesëmarrësve të praktikojnë një sekuencë me kalim pengesash anësore nga anët e djathta dhe të majta me ritmin 3 hapa ndërmjet pengesave

Sjellja e fillestarëve: Fillestarët në fillim do të kalojnë të gjitha pengesat nga e njëjta këmbë me të cilën bënë shkëputjen. Pastaj ata do të kenë vështirësi të vazhdojnë me vrapimin pas kalimit të pengesave nga të dyja anët. Ata kanë tendencën të jenë shumë larg nga drejtimi i vrapimit



Udhëzime për ushtrimin:

- Shkëputu sa më afër që të jetë e mundur nga drejtimi i vrapimit
- Vazhdo të vraposh direkt pas kalimit të pengesave

